

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7571 E mërkurë 27 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


**Ekskluzive** në "GSH"  
**K**orrupsioni! Nepotizmi! Korrupsioni dhe nepotizmi! Këshilli kombëtar kundër korrupsionit! Agjencia kundër korrupsionit! Java e luftës kundër ...  
Vijon në faqen 20

Nga REXHEP QOSJA  
**Bashkimi Evropian dhe korrupsioni në Kosovë**



**Opinion** i Ditës  
**H**anibal ante portas!(Hanibali përpara portës!)” thërrisin senatorët romakë kur elefantët e ushtrisë kartagjenase, të udhëhequr nga gjenerali i madh ...  
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI  
**Ofensiva e parasë kriminale**



Të arrestuarit: Paratë, të kushërinjve Vladi  
**Kapja e 3.4 milionë eurove, pronari i koncesionarit: Pati 2 ngarkesa të tjera**

Nis hetimi pasuror për porositësit, eurot e padeklaruaru ruhen në Bankën e Shqipërisë

INA ALLKANJARI

Pas bllokimit të 2 makinave "Toyota Yaris" në port, ku u gjetën të fshehur rreth 3.4 milion euro, mësohen detaje të reja nga hetimet që po zhvillon prokuroria e Durrësit. Nga hetimet e deritanishme ka dyshime se përgjatë ...

Në faqet 2-3

**DOKUMENTI/ KESHILLI EUROPIAN: VETING, LUFTË KRIMIT DHE KORRUPSIONIT**

## BRUKSELI: SHQIPERIA HAP NEGOCIATAT NE VITIN 2019

Rama: Shqipëria ia doli, lufta vijon. Bushati: Bastet e spekulantëve nuk dolën. Basha: Edhe vitin e ardhshëm, si sot, vendimi do të jetë refuzues



(Në foto) Këshilli Europian

Në faqet 2-3

**REFIMI**

**E dëbuan pas 24 vitesh në SHBA, emigranti: Nuk pashë as vajzat**

Në faqen 12

**PENSIONET**

**Të dypunësuarit, detyrimet për kontribute dhe përfitimet**

Në faqen 9

**DEBATI MES ARTISTEVE**

**Kastriot Çipi, Laert Vasilit: Ke ndërruar 3 herë parti**

Në faqen 18

**PAS PERMBYTTJES**

**Drejtoresha e Bibliotekës: Uji 2-3 cm, 13 metra poshtë nën tokë**

Në faqen 19

**KALENDARI I PLOTE**



**Zbardhen datat e provimit të licencës për infermierët**

Në faqen 11

Drejtori i Kurrikulës: Cilat janë degët më të kërkuara, 5545 vende në Bachelor

## Çlirim Duro: Kuotat në Universitetin e Tiranës

*"Nuk ka ndryshim tarifash. Më shumë interes për Informatikën dhe Drejtësinë"*

Nga VOLTIZA DURO

Universiteti i Tiranës do të hapë dyert për 5545 studentë të rinj që do të përzgjidhen në një nga degët e studimit për vitin akademik 2018-2019. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Çlirim Duro, drejtor i Kur-



rikulës në Rektoratin e këtij universiteti zbardh vendimin e miratuar në mbledhjen e fundit të senatit akademik. Sipas Duros, kuotat e pranimi në UT janë pothuajse njësoj krahasuar me një vit më parë, me diferenca shumë të vogla. Kështu ...

Në faqen 10

## “TOYOTA” ME EURO HETIMET

Ina Allkanjari

Pas bllokimit të 2 maki nave "Toyota Yaris" në port, ku u gjetën të fshehur rreth 3.4 milion euro, mësohen detaje të reja nga hetimet që po zhvillojnë prokuroria e Durrësit. Nga hetimet e deritanismme ka dyshime se përgjatë dy muajve maj dhe qershor të këtij viti të njëjtë persona të përfshirë në trafik kanë transportuar në Shqipëri edhe 2 ngarkesa të tjera me makina, përkatësisht 7 në çdo rrugë, makina kryesisht të tipit "Toyota Yaris" me anë të cilave mund të kenë futur sasi parash. Në rastin e fundit makinat rezultojnë se janë blerë në Belgjikë dhe kanë hyrë në Shqipëri duke ndjekur itinerarin Belgjike-Gjermani-Itali-Bari. Burimet thonë se prokuroria është vënë në gjurmim të mjeteve që kanë hyrë në territorin shqiptar si dhe po hetohet rruga deri në hyrjen e tyre në Shqipëri. Ngarkesa me makina e bllokuar ditën e diel rezultoi me dokumentacion të rregullt, kontratë shitblerje dhe deklarata doganore, të plotësuar në një koncesionar automjetesh të përdorura në Gjermani në pronësi të shtetasit Ilir Doçi, rezident prej vitesh në këtë shtet.

### PRONARI I KONCESIONARIT

Në një lidhje telefonike për emisionin "Opinion", Ilir Doçi, pronari i koncesionarit të automjeteve të përdorura në Gjermani, pohoi se makinat ishin blerë në Belgjikë dhe se dy personat, shoferi dhe djali i pronarit ishin paraqitur tek ai pasi si koncesionar i shitjes së makinave në Gjermani ka të drejtën të bëjë deklaratën doganore të gjithë makinave që hynë në vendin tonë. Ai sqaroi se nuk ndërhyr në makinat, por merret vetëm me përpilimin e dokumentacionit. Gjithashtu, Doçi pohoi se këta persona kanë blerë më herët makina tek ai, dhe për këtë pohim disponon dokumentet përkatëse, por mohoi të ketë njohje me dy kushërinjtë Vladi të shpallur në kërkim nga policia dhe që dyshohet të jenë porositësit e ngarkesës me makina. Ilir Doçi shtoi, gjithashtu, se automjetet që ishin blerë në Belgjikë, ishin në gjendje të mjerueshme. "Unë jetoj në Gjermani që nga viti 1992, kam një biznes që nga viti 2007 që shes makina të përdorura dhe një pikë servisi për tregun gjerman. Makinat në fjalë që janë nisur drejt Shqipërisë, nuk janë blerë në servisim tim. Unë kam mbyllur dhe kam

Pronari i koncesionarit: Mjetet u blenë në Belgjikë, nuk i njoh porositësit

# Bllokimi i 3.4 mln euro, Doçi: Janë transportuar dhe 2 ngarkesa të tjera

## "Unë bëra thjesht dokumentet"



Pronari i koncesionarit, Ilir Doçi

kryer të gjithë procedurën doganore, të gjithë makinave të ngarkuara prej 8 copë. Makinat që janë kapur në Portin e Durrësit, kanë ardhur të ngarkuara nga Belgjika. Unë si koncesionar i shitjeve të makinave në Gjermani kam të drejtën të bëjë deklaratën doganore të gjithë makinave që hynë në Shqipëri. Një makinë që të transportohet nga Gjermania dhe të shkojë në Shqipëri,

duhet patjetër të plotësojë dy kushte: 1 kontratë shitblerje dhe deklaratën doganore që duhet të shoqërojnë automjetin nga vendi ku niset deri në Portin e Durrësit. Nëse këto dy letra nuk e shoqërojnë automjetin, nuk ngarkohet në portet italiane. Në këtë rast kontrata e shitblerjes është bërë tek pika e koncesionarit të shitjes së makinave të mia. Unë kam ndihmuar shof-

erin, bashkë me djalin e pronarit për të gjithë dokumentacionin. Ata erdhën me makina të blera nga Belgjika, ndërsa unë u bëra veçse dokumentet", është shprehur Ilir Doçi. Për sa i përket faktit nëse ka pasur raste të tjera që këta persona kanë blerë në koncesionarin e Doçit, ai është shprehur se po kanë blerë makina, dhe i ka të gjitha të dokumentuara. Ndërkohë kushërinjtë Elvis

### KUSHËRINJTË VLADI

Ndërkohë kushërinjtë Elvis dhe Alfred Vladi janë fshehur, që pas kapjes së shumës rekord të parave. Policia ka kryer kontrolle në banesat e tyre, por pa rezultat. Ata dyshohet se kanë organizuar gjithçka për të futur 3.4 milionë eurot në Shqipëri, ndërsa burimi i parave mbetet ende mister.


### ILIR DOÇI

"Unë jetoj në Gjermani që nga viti 1992, kam një biznes që nga viti 2007 që shes makina të përdorura dhe një pikë servisi për tregun gjerman. Makinat në fjalë që janë nisur drejt Shqipërisë, nuk janë blerë në servisim tim. Unë kam mbyllur dhe kam kryer të gjithë procedurën doganore, të gjithë makinave të ngarkuara prej 8 copë. Makinat që janë kapur në Portin e Durrësit, kanë ardhur të ngarkuara nga Belgjika", u shpreh Ilir Doçi.

dhe Alfred Vladi janë fshehur, që pas kapjes së shumës rekord të parave. Policia ka kryer kontrolle në banesat e tyre, por pa rezultat. Ata dyshohet se kanë organizuar gjithçka për të futur 3.4 milionë eurot në Shqipëri, ndërsa burimi i parave mbetet ende mister. Hetuesit janë të bindur se ato vijnë nga aktivitetet kriminale, por hetimet pritet të hedhin më shumë dritë mbi këtë ngjarje.

### ARRESTIMET

Kujtojmë se rreth orës 15:00 të së dielës në portin e Durrësit u bllokua një sasi e madhe parash Cash në valutë të huaj. Konkretisht rreth 3.4 milionë euro mësohet të jenë fshehur në pjesën e pasme të dy automjeteve "Toyota" me tek derë, të ngarkuar në një kamion me 7 automjete të tjera. Burime nga policia bëjnë me dije se mjetet "Toyota Yaris" ku u gjetën eurot ishin nisur Belgjika, kaluan transit në Itali dhe dy net më parë u nisën nga Ankona për në portin e Durrësit. Bllokimi i makinave është bërë menjëherë sapo ka zbritur nga tragetit që vinte nga Ankona. Gjithashtu, mësohet se mjetet ku u gjetën paratë, dhe mjetet e tjera të cilat ndodheshin në auto-tren, ishin porositur për shitje në Shqipëri. Dyshohet se paratë e sekuestruara të jenë para të siguruara nga aktivitetet kriminale. Specialistët për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës në bashkëpunim me efektivistë e



"Toyota Yaris" që u bllokua në Durrës

Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nën drejtimin e Prokurorisë, finalizuan operacionin dhe kryen veprimet procedurale. Policia ka arrestuar në flagrancë shtetasit: Agim Çeka, 61 vjeç, lindur në Luz i Madh, banues në Durrës; Edi Lika (Cani), 41 vjeç, lindur në Dibër, banues në Tiranë; Klevis Lika, 21 vjeç, lindur në Bulqizë, banues në Tiranë; Alban Mollaymeri, 40 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasve: Alfred Vladi 33 vjeç, lindur në Peshkopë e banues në Tiranë; Elvis Vladi 38 vjeç, lindur në Peshkopë e banues në Tiranë. Gjatë kontrollit të ushtruar në Pikën e Kalimit Kufitar Durrës në automjetin tip "Bizar" të drejtuar nga shtetasi Agim Çeku dhe pronar Klevis Lika (Cani), në 2 automjete të ngarkuar në të, tip "Toyota" janë gjetur një shumë e konsiderueshme eurosh dhe franga zviceriane, të padeklaruara. Gjithashtu, janë ushtruar kontrolle në banesat dhe ambiente të tjera të personave të dyshuar. Janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 3,366,800 euro dhe 100 euro që dyshohet të jenë të falsifikuara; 80,000 franga zvicerane; 10 automjete, nga të cilat 7 automjete të tipit "Toyota Yaris", 1 tip "Alfa Romeo", 1 tip "Opel" dhe 1 tip "Bizar"; 1 armë kallashnikov me 2 krehra fishekësh, gjetur nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit A.Çeka; 1 radio policie; 7 telefona celularë.

## Nuk e kaloi vetingun, prokurorja Nikëhasani kërkon rikthimin në detyrë

Prokurorja e Shkodrës, Besa Nikëhasani e shkarkuar nga komisioni i vetingut për mosjustifikim pasurie, kërkon rikthimin në detyrë. Nikëhasani ka ankmuar vendimin në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, aty ku tashmë është caktuar trupa gjyqesore, e cila do të shqyrtojë ankimmimin. Ende nuk ka një datë për seancën ku Nikëhasani do të dalë para Kolegjit, ndërsa gjyqtarët që kanë në dorë fatin e saj janë Kryesues: Sokol Çomo, Relator: Albana Shtylla dhe anëtarë: Ardian Hajdari, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz. Më herët Komi-



sioni i Pavarur i Kualifikimit (vetingu) deklaroi se prokurorja e Apelit në Shkodër, Besa Nikëhasani nuk justifikon pasurinë. Për IL-DKPKI, prokurorja e ka ven-

dosur pasurinë në mënyrë të ligjshme, por KPK shprehet se pas verifikimit rezultoi se Besa Nikëhasani nuk justifikon dy apartamente, dy garazhe dhe një makinë fuoristradë Toyota Landcruis me vlerë rreth 20 mijë euro. Një nga apartamentet e prokurorës që nuk justifikohet ndodhet në Tiranë, tjetri në Lezhë. Por, Besa Nikëhasani që kishte zgjedhur që të mbrohej vetë, pa avokat, mohoi konstatimet e bëra nga trupa gjyqesore e KPK që përbëhej nga Suela Zhegu, Genta Tafa (Bungo) dhe Pamela Qirko.



Ina Allkanjari

Katër personat e arrestuar nga policia, si të përfshirë në kalimin nga Belgjika drejt Shqipërisë të 3.4 milionë eurove kanë mohuar para grupit hetimor të kenë pasur pjesë në këtë shumë parash. Ata mësohet të kenë pohuar se paratë nuk janë të tyre. Por shoferi i trailërit që transportonte makinat, si dhe pronari Edi Lika, kanë pohuar se paratë ishin të kushërinjve Elvis e Alfred Vladi. Ky i fundit njihet edhe me emrin Ramiz Vladi, të cilin mësohet se e ka ndërruar në Gjendjen Civile disa vite më parë. Pavarësisht se kanë pranuar se 3.4 milionë eurove janë të dy kushërinjve të shpallur në kërkim, 4 të arrestuarit nuk kanë pranuar të japin detaje mbi vendin dhe kohën e futjes së parave në dy makinat ku u gjetën ato, gjatë kontrollit të policisë në Durrës. Ndërkohë burimet bëjnë me dije se kartëmonedhat e huaja të padeklaruar që u gjetën brenda dy makinave "Toyota Yaris" mbrëmëse e së dielës do ruhen në Bankën e Shqipërisë. Bëhet fjalë për 3,366,800 euro, 80,000 franga zvicerane janë grupuar në dy qese dhe pritet të përdoren si provë për hetimet e mëtejshme. Milionat e eurove janë futur në qese provash. Mësohet se këto qese kanë një numër unik dhe janë njëpërdorimshme. Pra, nëse hapen dëmtohet edhe kodi numerik. Paratë në fjalë mësohet se janë transportuar në Bankën e Shqipërisë dhe do të ruhen aty deri sa të përfundojë hetimi për të akuzuarit, Agim Çeka, Edi Lika, Klevi Lika, Alban Mollaymeri dhe dy të shpallurit në kërkim Elvis dhe Alfred Vladi. Ndërsa mësohet se pasuria e Alfred dhe Elvis Vladi të shpallur në kërkim si porositësit e 2 Toyotave ku u gjetën paratë

Të pandehurit nën akuzë për jobëvënie dhe kërcënim

Shtyhet pretenca për bandën 'Shullazi', prokuroria s'ka gati konkluzionet



Emiljano Shullazi

Prokurorët Elisabeta Imeraj dhe Eneid Nakuçi dhe pse kishin planifikuar se këtë të martë do të lexonin kërkesat e tyre për pretencën ndaj Shullazit dhe katër të pandehurve kërkuar sërish kohë, pasi nuk ishin gati. Mos përgatitja e konkluzioneve përfundimtare nga prokurorët e procesit gjyqësor ndaj Emiljano Shullazit është bërë shkak për shtyrjen e seancës. Në seancën e shkuar pala mbrojtëse kërkoi të thirren si dëshmitarë disa punonjës të një banke të nivelit të dytë për të dëshmuar mbi disa çeqe që kanë lëshuar në emër të Gilmando Danit dhe Endri Qyqes, por kërkesa nuk u pranua nga gjykata. Gjyqi për

këtë çështje filloi në 10 maj të vitit të kaluar dhe gjatë seancave pati debate të forta mes prokurorisë, të pandehurve dhe dëshmitarit të mbrojtur, biznesmenit Ylvi Beqja. Shullazi akuzohet për një sërë veprash penale së bashku me katër shokët

e tij, Blerim Shullazi, Gilmando Dani, Endri Qyqja dhe Endri Zela, ndërsa prej më shumë se 1 viti ata janë përballur në gjyq dhe me provat dhe dëshmitarët e prokurorisë. Ai ka mohuar akuzat, duke u shprehur se mbahet padrejtësisht në

qeli, por sipas prokurorisë, ka prova që faktjnë aktivitetin kriminal të Shullazit dhe grupit të drejtuar prej tij në jobëvënie, shantazh dhe kërcënim. Banda 'Shullazi' akuzohet për veprat "shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë", në dëm të tre biznesmenëve, "Shkatërrim të pronës me eksploziv" në dy raste, dhe "kanosjes për shkak të detyrës" të profesorëve Dhori Kule e Mynyr Koni, krime të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal.

Kartëmonedhat e padeklaruar do ruhen në Bankën e Shqipërisë deri në përfundim të hetimit

"Toyota Yaris" me euro, zbardhen dëshmitë e 4 të arrestuarve: Paratë janë të kushërinjve Vladi

Nis hetimi pasuror për dy porositësit, sekuestro llogarive bankare



Elvis Vladi



Alfred Vladi

do të jetë subjekti i ligjit antimafia. Mësohet se do të vihen nën sekuestro pasuritë e tyre, llogari bankare dhe pasuri të tjera të paluajtshme. Të dy kushërinjët nga Dibra janë arratisur dhe dyshohet se kanë dalë jashtë vendit. Nga verifikimet e bëra në qendrën kombëtare të biznesit, dy kushërinjët Vladi rezultojnë pronarë biznesesh. Referuar këtyre të dhënave Elvis Vladi ka themeluar një kompani në shtator 2015, që ofron pjesë këmbimi për automjetet. Kushëri i tij Alfred Vladi rezultoi të ketë themeluar në gusht të 2017, një kompani me objekt kryesor dhënie me qira të automjeteve dhe Shërbime të këmbimit valutator, nën emrin e subjektit treg-

tar ("Tirana Rental Car"). Oficerët janë duke verifikuar edhe pasuritë e familjarëve të afërt të tyre për të parë nëse ata i justifikojnë ato. Në sitën e hetuesve do të kalojë dhe pasuria e 4 të arrestuarve të tjerë Agim Çeka, Edi Lika, Klevi Lika dhe Alban Mollaymeri. Ky i fundit ka në pronësi një servis pranë zonës së bregut të lumit në kryeqytet. Katër të arrestuarit pritet të dalin para gjykatës së Durrësit për t'u njohur me masën e sigurisë ditën e mërkurë dhe mësohet se prokuroria do të kërkojë arrest me burg për ta. Gjithashtu, mësohet se grupi hetimor, që është duke hetuar kapjen e 3.4 milionë eurove, ka kërkuar ndihmën e Agjencisë Britanike Kundër Krim-

it të Organizuar NCA. Prokurorët e kësaj çështjeje në mënyrë urgjente kanë kërkuar informacione për Elvis Vladin, i cili dy vite më parë është arrestuar në Londër për përfshirje në një grup kriminal i specializuar në trafikun e kokainës. 38-vjeçari Elvis Vladi rezultoi i arrestuar bashkë me tre shqiptarë të tjerë në Britaninë e Madhe më 19 maj 2015, gjatë një operacioni ku u sekuestrua një sasi prej mbi 10 kg kokainë. Ata u akuzuan pjesë e një organizate kriminale, për trafik droge, dhe posedim pasurie me anë të veprave penale. Të 10 anëtarët e grupit u dënuan, por i vetmi që u shpall i pafajshëm për mungesë provash ishte Elvis Vladi.

Shkarkohet drejtori i Emergjencave Civile, Shemsi Prençi, në vend të tij Haki Çako

Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka shkarkuar nga pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile, Shemsi Prençi. Në krye të kësaj Drejtorie mësohet se ka kaluar ish-drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Haki Çako. Mësohet se Prençi është shkarkuar përmes një njoftimi të ministres Xhaçka. Haki Çako merr drejtimin e Emergjencave Civile pas drejtimit për rreth 3 vite kur u shkarkua nga ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, në janar të këtij viti. Pas shkarkimit nga detyra e Drejtorit të Policisë, Çako u emërua si këshilltar në Ministrinë e Mbrojtjes në prill të vitit 2018. Çako vjen në drejtimin e Emergjencave Civile pas një eksperience gati 20-vjeçare. Çako ka nisur karrierën e tij në janar të vitit 1998, si shef i Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Kuçovë, e në muajin shtator të të njëjtit vit si shef i Policisë Kriminale të Komisarariatit numër 1, në Tiranë. Më pas, është emëruar si inspektor kundër Akteve Terroriste. Sakaq, në vitin 2003, ka mbajtur detyrën e specialistit në Zyrën e Luftës kundër Drogave të Forta, dhe më pas shef i Komisarariatit të Policisë Vlorë. Në vitin 2006 është emëruar specialist i Antiterrorit në Elbasan, për t'u larguar më pas me dëshirën e tij. Çako është rikthyer në vitin 2010 në Policinë e Shtetit dhe në 2013 është emëruar zëvendës-drejtor i Përgjithshëm për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, detyrë që e ka mbajtur deri në 31 mars të 2014. Për rreth 15 vite mësohet se Çako ka shërbyer në Policinë Kriminale dhe Hetimin e Krimeve. Ka qenë drejtues dhe pjesëmarrës në një sërë operacionesh policore, ku vlen të përmendet edhe operacioni antidrogë në Lazarat.

# RAPORTI I BE KONKLuzionet

Vendimi, rishikohet progresi për shkak të tri kushteve, drejtësisë, krimin dhe korrupsionit

Valentina Madani

Shqipëria humb shansin e hapjes së negociatave me 28 qershor 2018. Ky proces si për Shqipërinë ashtu dhe për Maqedoninë Veriore do të bëhet në qershor të vitit 2019. Ministrat e Jashtëm të BE-së shtynë dhe hapjen e negociatave për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë deri në qershor të vitit 2019, pasi Franca, Holanda dhe Danimarka shprehën rezervat për dy vendet gjatë një takimi të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, në Luksemburg. Vendet anëtare të BE, sa i takon Shqipërisë kanë theksuar rëndësinë që duhet të bëjë në progresin për reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në raportin e BE-së, theksohet rëndësia e zbatimit të reformës në drejtësi, dhe finalizimi i ngritjes dhe funksionimit të organeve të reja të sistemit si Njësia Speciale e Hetimit e Antikorrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) apo Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH). Ndër prioritetet kyçe të BE-së vazhdon të jetë reforma zgjedhore dhe lufta kundër krimin dhe korrupsionit, veçanërisht në nivelet e larta. Një tjetër pikë e raportit është ajo e uljes së numrit të azilkërkuësve.

### RAPORTI I PLOTË

Këshilli vlerëson progresin e reformave të Shqipërisë në përmirësimin e 5 prioritetëve kyçe, si reforma në administratën publike, reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimin të organizuar dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, përshirë të drejtat e minoriteteve dhe ato të pronës.

Ristrukturimi institucionial i gjyqësorit është një gur themel i një reforme gjithëpërfshirëse në drejtësi. Procesi i rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët (vetingu) ka nisur të japë rezultatet e para të preksheve, duke përfshirë edhe anëtarët e lartë të gjyqësorit, nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Këshilli inkurajon Shqipërinë që të vazhdojë bashkëpunimin e mirë me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit.

Këshilli inkurajon Shqipërinë që të vazhdojë progresin e deritanishëm dhe të ndjekë intensivisht reformën në drejtësi, që synon rritjen e pavarësisë, logaridhënies, profesionalizmit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor, përmes avancimit të procesit të vetingu, i cili është vendimtar për suksesin e tij.

Këshilli mirëpret përpjekjet për krijimin e një rekordi të qëndrueshëm në hetimet proaktive, ndjekjet penale dhe dënimet përfundimtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar;

# BE: Negociatat për Shqipërinë hapen me kusht në vitin 2019

## Bllokimi, tri vendet që votuan kundër



Takimi i djeshëm i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, në Luksemburg

### ANGELA MERKEL

Angela Merkel i propozoi Këshillit të BE shtyrjen e vendimit të datës 29, për shkak të kundërshtimit të Holandës e Francës. Paraditen e djeshme Kancelarja Merkel në punimet parlamentare në Bundestag ka kërkuar të mos ketë diskutim për Maqedoninë dhe Shqipërinë duke qenë se kundërshtia e Francës dhe Holandës e bën të pamundur vendimmarrjen në datë 29.

duke vënë në dukje se çmontimi i grupeve të krimin të organizuar mbetet një sfida e rëndësishme.

Këshilli thekson rëndësinë që Shqipëria të ndjekë më tej me rezultate të preksheve dhe të qëndrueshme luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës.

Këshilli inkurajon Shqipërinë që të vazhdojë dhe thellojë përpjekjet për të reduktuar kultivimin e kanabisit, duke u mbështetur në rezultatet e para të rëndësishme të vërejtura gjatë muajve të fundit.

Këshilli përgëzon Shqipërinë për bashkëpunimin e saj të ngushtë dhe të forcuar me agjencitë e zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare të BE-së dhe pret që kjo praktikë reciprokisht e dobishme të vazhdojë.

Këshilli nënvizon se Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet e saj në të gjitha këto fusha dhe duhet të sigurojë se rezultatet e mëtijshme duhet të arrihen edhe në luftën kundër korrupsionit në nivel të lartë, si dhe në çmontimin e rrjetëve kriminale të organizuara.

Në kuadrin e reformës së drejtësisë, institucionet e spe-

cializuara për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar ende duhet të krijohen sipas kuadrit ligjor tashmë në fuqi.

Krijimi i një procesi solid të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, në të gjitha nivelet, mbetet një objektivi thelbësor afatgjatë që kërkon përpjekje të mëtejshme, të strukturuar dhe të qëndrueshme.

Këshilli përsërit nevojën për masa efektive legjislative dhe politike për të përfunduar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe politikave kundër diskriminimit, duke përfshirë trajtimin e barabartë të të gjitha pakicave dhe qasjen në të drejtat e personave që u përkasin atyre në të gjithë Shqipërinë dhe për të siguruar zbatimin në përputhje të ligjit kuadër duke adresuar në aktet nënligjore përkatëse të gjitha çështjet e pazgjidhura, duke përfshirë të drejtën për vetë-identifikim të lirë.

Këshilli, gjithashtu, përsërit nevojën për zbatimin efikas të të drejtave pronësore.

Këshilli vëren se dialogu i qëndrueshëm dhe konstruk-

### JOHANNES HAHN

Me gjithë shtyrjen, Komisioneri për Zgjerim, e cilësoi vendimin e ministrave të Jashtëm si një provë për vlerësimin e progresit të rajonit. "Rrugëtimi drejt hapjes së bisedimeve të anëtarësimit në qershor të vitit 2019 është i qartë. Një sinjal kyç ky për rajonin se progresi i bërë shpërblehet, sikurse edhe vendimtar për besueshmërinë e vet BE-së", - tha Hahn.

tiv midis qeverisë dhe opozitës mbi reformat lidhur me BE është thelbësor për të avancuar në axhendën e reformave në dobi të qytetarëve dhe për të afruar vendin më pranë BE-së.

Këshilli përsërit se Shqipëria duhet të forcojë reformat që synojnë rritjen e konkurrencës dhe trajtimin e ekonomisë informale. Në përputhje me Konkluzionet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar, të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, Këshilli inkurajon Shqipërinë që të përmirësojë më tej klimën e biznesit dhe investimeve, duke përfshirë sigurimin e zbatimit të të drejtës së pronës, duke ndjekur me forcë konsolidimin fiskal dhe forcimin e administratës tatimore.

Këshilli mirëpret disa përpjekjet të bëra në liberalizimin e tregut të energjisë, infrastrukturën e transportit dhe digitalizimin.

Këshilli inkurajon Shqipërinë që të ndërmarrë hapa për të adresuar problemet e menaxhimit të mjedisit.

Këshilli e vlerëson fuqishëm vazhdimin e vazhdueshëm të Shqipërisë me Politikën e Përbashkët të Jas-

htme dhe të Sigurisë të BE-së.

Këshilli mirëpret angazhimin dhe përpjekjet në luftën kundër terrorizmit ekstremizmit të dhunshëm si dhe inkurajon Shqipërinë që të vazhdojë më tej përpjekjet.

Këshilli përsërit angazhimin e vazhdueshëm konstruktiv të Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal. Këshilli, gjithashtu, mirëpret që Shqipëria të intensifikojë dialogun me vendet fqinje për të trajtuar çështjet të rëndësishme dypalëshe dhe për të siguruar marrëdhënie të mira fqinjësore, të cilat mbeten thelbësore.

Këshilli vë në dukje pozitivisht përpjekjet e Shqipërisë për të vendosur masa efektive që synojnë ulin kërkesat e pabazuara për azil, të parqitura nga shtetasit shqiptarë në vendet anëtare të BE-së. Këto masa duhet të ndiqen më tej, së bashku me bashkëpunimin dhe dialogun e vazhdueshëm me vendet më të prekura, derisa të arrihen rezultatet e qëndrueshme.

Duke pasur parasysh përpjekjet e mësipërme, në veçanti për pesë prioritetet kyçe, Këshilli pajtohet që t'i përgjëjë pozitivisht progresin të mësipërm të bërë nga Shqipëria dhe përcakton rrugën drejt hapjes së negociatave për vendimmarrje në qershor të vitit 2019.

Në mënyrë të veçantë, Këshilli thekson nevojën kritike për të konsoliduar më tej progresin e bërë në reformën gjyqësore në veçanti përmes verifikimit dhe për të dhënë rezultate të tjera të preksheve në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet dhe në luftën kundër krimin të organizuar; veçanërisht në kultivimin dhe trafikimin e drogës, ruajtjen dhe duke thelluar momentin aktual të reformës.

Kjo përfshin: avancimin e mëtijshëm të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe



prokurorëve, në veçanti duke plotësuar të gjitha dosjet prioritare dhe finalizimin e themelimit të organeve të specializuara, përkatësisht Strukturës Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe Byrosë Kombëtare të Hetimeve (NBH) dhe Gjykatës; - forcimi i procesit të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar; duke përfshirë edhe në nivel të lartë.

Për këtë qëllim, Këshilli i bën thirrje Komisionit që të monitorojë nga afër përpjekjet e mësipërme të reformës nga Shqipëria dhe do të vlerësojë progresin në bazë të raportit vjetor të Komisionit.

Këshilli rikujton që vendimi për të hapur negociatat me Shqipërinë do të jetë subjekt i përfundimit të procedurave parlamentare dhe miratimit nga Këshilli Evropian dhe do të pasohet pas kësaj nga Konferenca e parë ndërqeveritare deri në fund të vitit 2019, në varësi të progresit të bërë.

Këshilli thekson që ky vlerësim i progresit duhet të përfshijë rezultate të tjera të preksheve dhe të qëndrueshme duke u përqendruar në veçanti në sundimin e ligjit.

Për zgjedhjet, Këshilli i kushton një rëndësi të veçantë Shqipërisë duke adresuar rekomandimet të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Zyrën e Evropës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut.

Këshilli, gjithashtu, i kushton një rëndësi të veçantë përpjekjeve të vazhdueshme të Shqipërisë për të zvogëluar numrin e kërkesave për azil që duken të pabazuara dhe, gjithashtu, i kërkon Komisionit të sigurojë që kjo të merret në konsideratë.

**SHPLLJE ANKANDI**  
Datë 02.07.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 040506426, Cel. 067 201 9460/069 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpell ankandim e parë për pasurinë e pajualtshme të debitorit Shoqëria "VIGAND Konstruksion" sh.p.k. "Njësi" me sipërfaqe 265, 22 m<sup>2</sup>, nr. i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresë: Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë.

Cmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 339 482 (treqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) EUR.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.



Qeveria pret pozitivisht vendimin e Këshillit të Ministrave të BE

# Rama: Shqipëria ia doli, lufta vijon Bushati: Bastet e spekulantëve s'dolën

*Basha: Momenti i një kthese të madhe për vendin*

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama e cilësoi si pozitiv vendimin e që mori dje, Këshilli i BE-së për caktimin e qershorit 2019 si datë për negociatat me Shqipërinë. Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", kryeministri shkroi: "Pas 72 orësh mes dallgëve të brendshme të BE-së, Shqipëria ia doli të marrë datën për hyrjen në portin e Europës së Bashkuar. Rezultatet e reformave tona bënë që dhe më skeptikët të njohin meritën e Shqipërisë e të Maqedonisë. Një betejë tejte e vështirë u fitua, lufta vijon". Ndërkohë, edhe ministri i Europës dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, u shpreh dje, pas vendimit të BE-së se kjo është një përgjigje pozitive për anëtarësimin në bllokun europian. Bushati deklaroi se "Këshilli i kërkoi Komisionit Europian që të fillojë pa humbur kohë procesin përgatitor me Shqipërinë duke qenë se ka skicuar qartë rrugën për bisedimet për anëtarësimin. Gjithashtu, ka përcaktuar një afat kohor, qershorin e 2019 për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin". Ai thekson se "është një praktikë e njohur për BE, i cili edhe në rastin e Serbisë, edhe në rastin e Malit të Zi ka përcaktuar një afat kohor, ku ndodhi puna përgatitore. Komisioneri Johannes Hahn është



Ministri i Europës dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati

**LULZIM BASHA**  
"Hapja e negociatave për Shqipërinë u shty edhe për një vit. Krimi dhe korrupsioni po mbajnë peng të ardhmen tonë. Pa luftuar krimin dhe korrupsionin, vendimi në 2019 do jetë refuzues si sot. Tani është momenti për një kthesë të madhe për të shpëtuar vendin dhe të ardhmen tonë europiane", u shpreh dje, kreu i PD-së.

## Shtyrja e negociatave, PD: Bushati të japë dorëheqjen

Pas vendimit të BE të bërë publik nga Johannes Hahn dhe reagimit nga ministri i Evropës dhe Punët e Jashtme, reagoi PD me kërkesën për largimin e ministrit të Jashtëm. Deputeti Tritan Shehu në emër të PD-së kërkoi dorëheqjen e Ditmir Bushatit. Pse dhe cilin falënderon ministri Bushati për dështimin e negociatave?! Më e ndershme do ishte të jepte dorëheqjen se bashku me qeverinë Rilindëse. Falënderon se ministrat e Jashtëm të BE-së rrezuan propozimin e Komisionit?! Falënderon se Samiti as do ta marrë në shqyrtim Shqipërinë?! Falënderon se gjithçka do të shqyrtohet ndoshta në qershor të 2019?! Nuk u miratua asnjë çelje, as me kusht e as pa datë. Pra, çdo gjë nga fillimi, si vite më parë, si që nga 2013-ta. Fatkeqësi kombëtare kjo nga keq qeverisja, bashkëjetesa me krimin, drogën, korrupsionin, nga modelet Lindore, që deklarohet nga kjo qeveri se po aplikon në nja vend perëndimor. Në fakt, të gjitha bashkë këto edhe të tjera...", shprehet deputeti i PD-së.



### MAJLINDA BREGU

"Shqipëria dhe Maqedonia kanë një datë zyrtare për çeljen e negociatave. Është super lajm që në një Europë mes një deti problemesh dhe Ballkani Perëndimor me demokraci në krizë, nuk braktiset e degdiset në harresë bashkimi i rajonit tonë me Europën, por konfirmohet rruga e anëtarësimit. Por deri në 2019 kemi jo pak për të bërë për t'i treguar shqiptarëve dhe Europës se jemi seriozë dhe e kemi serioziteti!", tha dje, ish-ministria.

të shprehur shumë qartë sot. Ne besojmë se tanimë Shqipëria është në rrugën e pakthyeshme në procesin e integritimit në BE". Kryediplomati Bushati thekson se "diskutimet e sotme (e djeshme) dëshmuar një gjë që kemi kohë që e themi; kursi i reformave që ka ndërmarrë Shqipëria sidomos nga momenti i marrjes së statusit kandidat është një kurs reformash

impresionues, i cili duhet të thellohet më tej në ditët dhe muajt në vijim". "Do të uleri me KE pa humbur kohë në mënyrë që qershori i vitit të ardhshëm ta gjejë Shqipërinë në një proces sa më solid. Sot, gjithashtu, ishte një ditë e rëndësishme edhe për vetë projektin europian", nënvizoi Bushati duke shtuar se "72 orët e fundit kanë qenë orë të vështira ku na është dashur

të komunikojmë me të gjitha nivelet vendimmarrëse për të komunikuar me detaje procesin e reformave". "Për fat të keq, këto ditë një pjesë e mirë e politikës shqiptare, e medias kishin vendosur 28 qershorin si ditën e bastit apo larjes së hesapeve me qeverinë dhe Edi Ramën a thua se procesi i integritimit ka lidhje me fatin e një qeverie. Ky është një proces që ka lidhje me fatin e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Më vjen mirë që basti i këtyre spekulantëve nuk u përmbush sot. Sot nuk është një ditë e gëzuar vetëm për qeverinë, por është një ditë e gëzuar për gjithë popullin shqiptar", tha ministri. "Shpresoj që askush pavarësisht bastit të gabuar që kish vënë nuk duhet që të ndihet i përjashtuar nga kjo ditë dhe ky sukses i përbashkët", shtoi ai.



## FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

Thirrje për propozime

Thirrje për kontraktor për kryerjen e një anketimi për Sistemin e Matjes së Sigurisë në Komunitet në dy qarqe, në Kukës dhe Elbasan:

- |                   |   |
|-------------------|---|
| Lloji i Kontratës | - Konsulencë afatshkurtër   |
| Gjuhë e kërkuar   | - Anglisht dhe Shqip  |
| Vendndodhja       | - Elbasan, Librazhd, Peqin, Cerrik, Gramsh, Kukës, Has dhe Bajram Curri |
| Data e fillimit   | - 16 Korrik 2018  |

Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK) do të përdoret për të matur nivelin e sigurisë ku përfshihen nivelet e kriminalitetit, apo të problemeve të rendit publik si dhe siguria në qarkullimin rrugor dhe kënaqësia e publikut për punën e policies në zona të vogla dhe të përcaktuara qartë.

Termat e referencës për këtë studim mund të shkarkohen nga faqja e internetit [www.cp-projec.al](http://www.cp-projec.al)

Afati për dërgimin e aplikimeve: - 9 korrik 2018, ora 17:00

Aplikimet duhet të dërgohen me email në [info@cp-project.al](mailto:info@cp-project.al).

## Kreu i Komisionit të Integritimit: Kjo qeveri e pafytyrë Pollo: BE na refuzoi, Rama e Bushati duhet të kishin dhënë dorëheqjen

Kryetari i Komisionit të Integritimit, deputeti i PD-së Genc Pollo tha dje, se "BE ka vendosur për të mos hapur negociatat për shkak të korrupsionit dhe të krimit qeveritar". "Franca dhe Holanda kanë vënë veton, kurse Gjermania ka kërkuar hapje negociatash me kushte. Vendimi do të rishqyrtohet pas një viti nga Këshilli Europian, i cili do të vendosë vetëm kur të verifikohet se Shqipëria i ka plotësuar kushtet, dhe

vetëm pas miratimit paraprak nga ato parlamente të vendeve anëtare që duhet të shprehen", theksoi Pollo. Por, shtoi ai, edhe në këtë ditë të hidhur për shqiptarët qeveria ka pafytyrësinë të mashtrojë dhe gënjejë duke

thënë se janë hapur negociatat. Ministri i Europës duhet të kishte dhënë dorëheqjen sot bashkë me shefin e tij. Por të pafytyrët nuk njohin as moral dhe as përgjegjësi, u shpreh Pollo.

**REPUBLIKA E SHQIPËRIE**  
Zyra përmbarimore "Best 2018"

**SHPALLJE ANKANDI**

Mbi datën 3 shtator 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 le të kjo zyre përmbarimore do zhvillohet ankandit për shpallje e pasurisë së shqiptarëve "Konfort" shteg.

Apartamenti/zyra që do të shitet ndodhet në ZK 8310, Rr"Orlani Hoza", Tiranë (kallë 7) ndërtesës, mbi zyrat e Bankës NBO). Për më tepër dhe detajet e kësaj shpalljeje mund të kontaktohen në numrin e telefonit të kësaj zyre përmbarimore.

Cmimi filluesar me të cilin hapet ankandit është 11.772.000 lekë.

Cmimi filluesar edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditës.

P.s: Cytëtarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit filluesar si garanci për pjesëmarrjen në ankand. Kjo garanci pasurore duhet të jetë e dorëdhur në BKT, rr. Illogarise Sëlime Hoza PF (BANI, AUJ7 2051 2046 4204 9831, FRCLALLA)

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000  
E-mail: best2018@perrbarues.al, web: www.perrbarues.al

# AKUZAT PËR EUROT REAGIMET

Lidhja me 3.4 mln eurot, kreu i Grupit të PS padit kreun e PD-së

## Balla: Bashën do e bëj shembull, pati rrjedhje informacioni nga një institucion

"I gatshëm të më bëhet gjyqi në sheshin "Skënderbej"

Darina Tanushi

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroi dje, se do ta bëjë shembull kreun e PD-së, Lulzim Basha, duke e paditur për akuzat ndaj tij, në lidhje me eurot e kapura në portin e Durrësit. Në një deklaratë për median, deputeti socialist tha dje, se, nëse ai ka lidhje me këtë ngjarje, pret të gjykohet në sheshin "Skënderbej".

"Kjo akuzë nuk qëndron në asnjë përqindje të saj", u shpreh dje, Balla, duke iu drejtuar socialistëve që e kanë mbështetur. "Kjo akuzë është nxjerrë nga goja e zotërisë në një moment të papërgjegjshëm, në një secancë ku të gjithë qeshnim me përpjekjen donkishoteske të Lulzim Bashës se, goja kish bërë të pamundurën për të ndihmuar Shqipërinë në hapjen e negociatave. E vazhdoi papërgjegjshmërinë e tij edhe dje, edhe sot. Sigurisht që deklarata e Policisë së Shtetit ishte shteruese për sa i përket personave të arrestuar, personave ende në kërkim, të cilët përbëjnë të gjithë grupin kriminal dhe gjej rastin të përgëzot Policinë e Shtetit që akcione si ky, të ketë sa më shumë dhe që prapa hekurave të shkojnë të gjithë këta delinkuentë e kriminelë, të cilët trafikojnë apo transportojnë sende të ndaluara me ligj, qofshin këto para", drogë, e çfarëdo të jetë kjo", u shpreh Balla.



Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla

### AMBASADORJA E RE

SHBA kanë sjellë në Shqipëri emrin e ambasadores së re që do të zëvendësojë për pak javë Donald Lu. Ajo është diplomatja Kathleen A. Kavalec, Zv.ndihmës sekretare në zyrën e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike. Para kësaj, ka qenë Zëvendës Shefe e Misionit dhe Zëvendës Delegation e Përhershme në Misionin e SHBA në UNESCO, në Paris (2010-2013).



Gjatë një seance parlamentare

### Kreu i OSBE e partitë bien dakord për ndëshkimin e partive

## Borchardt: KQZ të refuzojë listat e partive nëse nuk plotësojnë kuotën gjinore

Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Bernd Borchardt, rekomandoi dje, që në Kodin Zgjedhor të kthehet dispozita që lejon refuzimin e listave të kandidatëve të partive që nuk plotësojnë kuotën gjinore. Duke folur në një konferencë për gratë në politikë, organizuar nga UN Women, Borchardt tha: "Kodi Zgjedhor i mëparshëm përmbante një dispozitë, që lejonte refuzimin e listave të kandidatëve të partive që nuk plotësonin kuotën gjinore ligjore. Kjo dispozitë është hequr në Kodin e tanishëm. Ne rekomandojmë fuqimisht rivendosjen e dispozitës që lejon refuzimin e listave të kandidatëve të partive që nuk plotësojnë kuotën gjinore. Thjesht, vendos-



ja e një gjobe për partitë politike, listat zgjedhore të të cilave nuk plotësojnë kuotën gjinore, nuk e çon përpara kauzën e grave në politikë q'u aq mirë sa refuzimi i listave". Borchardt shtoi se prirja pozitive e viteve

të fundit lidhur me pjesëmarrjen e grave në politikë duhet të ruhet e të çohet më tej. Propozimi i OSBE u mbështet dhe nga përfaqësuesit e dy partive të mëdha në vend. Kryetarja e PS-së për Tiranën, Blerina Gjylameti tha: "Të heqim këto penalitete dhe ta bëjmë të detyrueshme. Pra, refuzim të listës në momentin kur nuk është 30 %". Ndërsa deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi u shpreh: "Të bëhet menjëherë refuzimi i drejtpërdrejtë i listave që nuk plotësojnë një minimum të diskutueshëm". Sipas një studimi të UN Women në Shqipëri gratë kanë pengesa për t'u përfaqësuar dhe për të marrë pjesë në zgjedhje. Më problematike në këtë drejtim janë Lezha, Elbasani dhe Kukësi.

### NEGOCIATAT ME BE

"Procesi është i gjatë, unë bëj pjesë në ata shqiptarë që e duam Shqipërinë sa më shpejt në Bashkimin Europian, por një Shqipëri me dinjtet dhe një Shqipëri ku të gjithë të vendosim nga një gurë në rrugën tonë evropiane dhe jo ta qëllojmë me vezë e me domate e me bidonë, pastaj të themi që duam dhe ne kreditet tona për punën e palodhur që kemi bërë në interes të Shqipërisë", -tha dje, Balla.

## Kryemadhi në Washington: Ardhja e 600 mijë sirianëve, lojë e qeverisë "Rama"

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi ishte e ftuar këto ditë, në takimin vjetor të organizuar në Uashington, ku u fol edhe për integrimin e Shqipërisë në BE si dhe krizën e emigrantëve në kontinentin evropian. Ndërsa në lidhje me 600 mijë sirianët në Shqipëri, Kryemadhi shprehet se është një lojë e qeverisë "Rama" në kurriz të shqiptarëve. "E ftuar në takimin vjetor organizuar në Uashington, ndër të tjera biseduam për integrimin e Shqipërisë në BE dhe krizën e emigrantëve që po përjeton së fundmi kontinenti ynë. Ndër të tjera, e rëndësishme për bashkëbiseduesit amerikanë ishte fakti që kriza e emigrantëve në Europë kërkon një qasje të re në qëndrim. Kjo ka të bëjë sipas tyre edhe me forcimin e shteteve evropiane, si dhe me ndryshimin rrënjësor të jetës politike dhe ekonomike të vendeve që eksportojnë refugjatët", u shpreh Kryemadhi, përmes një statusi në "Facebook". Sipas saj, "keto politika do të dekurajonin largimin masiv të njerëzve dhe do të krijonin kushte më të mira për popullsinë e vendeve që janë burim për emigracionin e paligjshëm. Ky është vizioni që duhet të ketë Shqipëria për të punuar për të rinjtë e Shqipërisë dhe jo për të asgjësuar çdo shans të tyre. Loja e qeverisë me refugjatët është një lojë tërësisht në kurriz të shqiptarëve", tha Kryemadhi.



### Njoftim për shitje ankad II

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e Hipotekuesit A Milia. Pasuria që shitet në ankad përbëhet nga:

- "Apartamenti" me numur pasurie 1/126+1 - 4 Zonë Kadastrale B170 Volumi 1, Faqe 154, me sipërfaqe 75.1 m<sup>2</sup>, në adresën Rr "Q Stafar" pall 8, shk 1, kati dyte , Ap 4 Tiranë
- Ankand i pasurisë fillon me crmimin me të ulet në masën 30 përqind të ankandit të parë. Ankand do të zhvillohet 13.07.2018 në orën 15:00 në selinë Bulev "G Frashëri" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Kontaktet: tel: 672082543 e-maili: [llir\\_dervishaj@yahoo.com](mailto:llir_dervishaj@yahoo.com) si dhe [WEB www.powerjustice-al.com](http://WEB.www.powerjustice-al.com).

kemi bërë gjithmonë akuzat ndaj njëri-tjetrit, por kurrë një gjë të tillë. Pa asnjë lloj lidhje dhe pa asnjë lloj provë, na del q'u dhe na thotë se pas ka pasur shërbime partnere që ia komunikuan këtyj. Nuk është e vërtetë. Me përgjegjësi e deklaroi që nuk ka asnjë shërbim partner

apo ndërkombëtar që t'i raportojë këtyj delinkuenti, përkundrazi. Por që ende ka ndonjë militant, ndonjë shërbim inteligjence të brendshëm që transferon Sms informacioni konfidencial në kuadër të zhvillimit të një aksioni të rëndësishëm policor dhe që në një

rrëz akcionin, kjo është e vërtetë", -theksoi Balla. Ai kërkoi që prokuroria të thërrasë të parin Lulzim Bashën që pretendon se ka çdo informacion. "Kësaj radhe të jeni të sigurt që faljen do t'ia kërkoj me vendim gjykatë!", u shpreh Balla për Bashën.

rrëz akcionin, kjo është e vërtetë", -theksoi Balla. Ai kërkoi që prokuroria të thërrasë të parin Lulzim Bashën që pretendon se ka çdo informacion. "Kësaj radhe të jeni të sigurt që faljen do t'ia kërkoj me vendim gjykatë!", u shpreh Balla për Bashën.



Plas sherri në Komisionin e Veprimtarisë, mazhoranca bojkoton mbledhjen

# PD, Mima: Me lejet e ndërtimit pastrohen paratë e pista

## "Na tallët deri në sarkazëm, por koha na dha të drejtë"

Valentina Madani

Paratë e "Toyota"-ve të kapura në Durrës u bënë dhe shkak për debate të forta në Komisionin parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese mes mazhorancës dhe opozitës. Florion Mima, nënkryetari i këtij komisioni, deklaroi se paratë e drogës po pastrohen në sektorin e ndërtimit. "Bumi i rritjes së lejeve të ndërtimit 300% në këtë periudhë kohë nuk është gjë tjetër veçse materializimi i një plani mafioz për të arritur e për të shpëlarë të gjitha këto para në sasi tmerrësisht të madhe. Aq të mëdha sa tronditin parametrat monetare dhe fiskalë të vendit", u shpreh Florion Mima.

Sipas tij, me këtë qeveri është e pamundur që të hapen negociatat me Shqipërinë. Përfaqësuesi i PD-së në komision, Florion Mima hodhi akuzë edhe në drejtim të kreut të grupit parlamentar të PS, Taulant Balla se ka lidhje me shumën e eurove të sekuestruara në Durrës. Sipas tij, bumi i lejeve të ndërtimit tregon se po shpëlahen paratë e pista. "Nuk mund të shkohet në Europë kur numri dy i partisë suaj akuzohet nga kreu i opozitës së është pritisë i një 'Toyot'-e dhe fatkeqësisht rezulton se lideri i qpozitës ka të drejtë. Dy ditë më mbra pa shohim që 'Toyota' është edhe me 'trade marke' e përshkruar, edhe me sasinë e parave të fshehura në të. Ju qeshni dhe vazhdoni të qeshni, por ky është një cikël i mirëmen-duar që nisi me kanibizimin e vendit dhe vazhdoi me përfshirjen e vendit në listën e vendeve kryesore për trafikimin e heroïnës dhe kokainës në Europë. Vazhdon me hapin e katërt që është shpëlarja e parave, e këtyre parave të pista që vijnë nga këto aktivitete, nëpërmjet një aktiviteti që është ndërtimi. Opozita ju ka thënë me kohë që bumi i rritjes së lejeve të ndërtimit 300 për qind në këtë periudhë kohë nuk është gjë tjetër veçse materializimi i një plani mafioz për të arritur e për të shpëlarë të gjitha këto para në sasi tmerrësisht të madhe", tha Mima. Gjatë mbledhjes së djeshme të komisionit u diskutua për tarifën telefonike roaming. Kryetari i Veprimtarisë



Komisionin parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese

### AKUZA

"Bumi i rritjes së lejeve të ndërtimit 300% në këtë periudhë kohë nuk është gjë tjetër veçse materializimi i një plani mafioz për të arritur e për të shpëlarë të gjitha këto para në sasi tmerrësisht të madhe. Aq të mëdha sa tronditin parametrat monetare dhe fiskalë të vendit", u shpreh Mima.

### SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha ironizoi dje kreun e grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, pas kësaj se 3.4 milionë eurove të fshehu në dy "Toyota". Përmes një fotomontazhi, Berisha nuk ka dashur të japë komente, ndërsa sipër dy fotove shkruhet: "Kërkon gjithë jetën qerosin me 'X6'" si dhe "Shikon në rrugë katundarin me 'Toyota' e 5 milionë euro në bagazh".



### DROGA

"Do mjaftonin vetëm 13 'Toyota Yaris' për të mbushur grupën 5-mujore të arkës së shpuar të 'qeverisë koncesionare'. Do mjaftonin vetëm 13 'Toyota Yaris' që buxheti të mos rishikohet me ulje të ndjeshme pas 1 muaji, ulje në kurriz të investimeve, rrogave, pensione, shtresave në nevojë", tha Teliti.



"Për derrkucin me 'Toyota', që s'zgjërdhiet më"

## Paloka, Ballës: Pse nuk e kallëzon që sot Bashën?

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka i përgjigjet Taulant Ballës. Pasi Balla doli sot para mediave dhe tha se do të kallëzonte në prokurori kreun e PD-së, Lulzim Basha brenda kësaj jave, Paloka e pyet përse nuk e bën që sot akuzën në prokurori për të? Nuk mungojnë as fyerjet për kreun e grupit parlamentar të PS-së, që Paloka e cilëson si "derrkuci me 'Toyota'". "Pse nuk zgërdhiet më derrkuci me 'Toyota'? Taulant Balla, një derrkuc i dhjamur nga paratë e drogës që pastron bashkë me bandën e Elbasanit, sot nuk u zgërdhi. Taulantit i ka ikur zgërdhija. Taulantit i ishte tharë buza e mezi fliste. Taulanti u përtpye u përtpye si derrkuc i dhjamur; i ngecur në baltë, po nuk tha asgjë. Sepse derrkuci e di që ka ngecur në baltë. Dy pyetje për derrkucin me 'Toyota': Akuzën në prokurori për Lulzim Bashën, pse nuk e bën që sot, po ke vendosur të presësh deri në fund të javës? Aktorin e Babales pse nuk e nxjerr që sot që ta shohësh e gjithë Shqipëria, po e mban kaq gjatë të fshehur? Për ta kuptuar hallin e madh që ka e zënë derrkucin e 'Toyotës', kujtoni se çfarë thoshte derrkuci për avionët e drogës para tri vitesh, kujtoni se çfarë thoshte derrkuci për Saimir Tahirin, çfarë thoshte derrkuci për Elvis Rroshin, çfarë thoshte derrkuci për Agron Xhafajn", shprehet z.Paloka.

### SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 03.07.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i përshfitjen e pasurisë të paluajtshme Truali me sipërfaqe totale 500 m<sup>2</sup> nga e cila Ndërtimesë me sipërfaqe 128 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurisë 72/67-Vol.3, Fa.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jasmaku me vlerë fillestare në ankand 128.640 (Njëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

## Kapja e 3.4 mln eurove, ironia e demokratit

## PD, Teliti: Do mjaftonin 13 'Toyota' për grupën e shpuar të qeverisë

Këshilltari për çështjet ekonomike në grupin parlamentar të PD, Dorjan Teliti iu është bashkuar reagimeve lidhur me sekuestrimin e 3.4 milionë eurove në portin e Durrësit, ku opozita akuzon Taulant Ballën si porositës. Teliti shprehet me ironi se, "do mjaftonin vetëm 13 'Toyota Yaris' për të mbushur grupën 5-mujore të arkës së shpuar të 'qeverisë koncesionare'". Teksa nënvizon disa sektorë për të cilët sipas tij nuk ka fonde, Teliti thekson se ka bollshëm para për një grup oligarkësh që marrin nga arka e shtetit. "Do mjaftonin vetëm 13 'Toyota



Yaris' për të mbushur grupën 5-mujore të arkës së shpuar të 'qeverisë koncesionare'. Do mjaftonin vetëm 13 'Toyota Yaris' që buxheti të mos rishikohet me ulje të ndjeshme pas 1 muaji, ulje në kurriz të investimeve, rro-

gave, pensione, shtresave në nevojë. Vetëm gjatë 5 muajve të parë të vitit mungojnë plot 57 milionë dollarë nga tatimet dhe doganat. Mosrealizime praktikisht në çdo zë të të ardhurave, nga TVSH (-28 milionë dollarë) e deri të tatimi mbi të ardhurat personale (-10 milionë dollarë). Ama ka bollshëm para për një grusht njerëzish, për oligarkët që përpjijnë çdo ditë arkën e shtetit, arkë e cila mund të mbushet lehtësisht me vetëm 13 'Toyota Yaris'. Çmim të shtrenjtë po paguajnë shqiptarët për arrrogancën e qeverisjes 'koncesionare' të padrejtësive", shprehet z.Teliti.

Prodhuese, Eduard Shalsi gjatë mbledhjes deklaroi se do të heqë tarifën roaming me Kosovën. Po ashtu, Shalsi tha se parlamenti kosovar e ka gatë draftin dhe pritet që të firmoset nga pala shqiptare. Por nuk munguan as debatet me tone të ulëta

mes Shalsit e deputetit të PD-së, Florion Mima, ku ky i fundit u shpreh se: "U thamë se me këtë qeverisje nuk do t'ia dilnit të bindnit qeveritë evropiane për negociatat. Na tallët deri në sarkazëm, por koha na dha të drejtë fatkeqësisht fjalët e Bashës për

'Toyota' dhe para të fshehura në PD-së, Florion Mima, ku ky i fundit u shpreh se: "U thamë se me këtë qeverisje nuk do t'ia dilnit të bindnit qeveritë evropiane për negociatat. Na tallët deri në sarkazëm, por koha na dha të drejtë fatkeqësisht fjalët e Bashës për



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

## OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

### 1. GENERAL CONDITIONS

**1.1 Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1

**1.2 Profile:** The Programme "Customer Oriented Drinking Water and Sanitation Services" is implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ). The objective of the programme is to support the partners at central and local level in the implementation of the water sector reforms. At local level the programme supports three partner municipalities and their water utilities in the improvement of drinking water and sanitation services, especially performance orientation, accountability and in customer orientation.

**1.3 Subject:** The Government of Albania has started a reform on water supply and sewerage sector aiming to improve the service to the citizens, to enhance the water supply continuity and to shift the sector towards better performing.

The Government of Albania aims to expand access to and enhance the quality of water supply and sewerage services for the entire population of Albania. The ultimate aim is to provide piped water supply to all people and to provide wastewater services to protect human health and minimize negative environmental impacts. This aim will be achieved taking into account the overall policy framework:

- Government sector policies operate within a macro-economic framework that limits overall public debt and is based on sound macro-economic policies.
- The Government will give emphasis to the need to protect the poor and vulnerable inter alia by ensuring that their utility bills are within international norms for affordability.

- Albania is an EU candidate country and Government sector policies are designed with the adherence to the EU environmental acquis in mind.

Within the context of the above Background Information, the Government of Albania is seeking to retain the services of a Consultancy with proven experience in the development of water sector strategic documents, that would assist the Government to:

- Prepare twelve (12) year water supply and sewerage services sector strategy, to include an implementation monitoring mechanism.
- Recommend appropriate initiatives and procedures to support the water supply and sewerage services sector reform effort.
- Recommend and quantify the effort needed, at the national and utility level, to ensure that a capable work force is being prepared to assume operational and maintenance responsibility that will be needed to protect the assets being created under the sector capital investment program.

GIZ now invites eligible national consulting companies to indicate their interest in providing the required Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

**1.4 Eligibility:** Participation is open to all eligible national consulting companies (participating either individually or in a grouping — consortium — of tenderers) which are effectively established in Albania.

All legal entities interested in the application process should ask for application forms to the address: [giz-albanien@giz.de](mailto:giz-albanien@giz.de)

2. The **due date** for submitting the application is **06.07.2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: **National Water Supply and Sewerage Services Sector Strategy for Albania 2018-2030**" to:

**Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)  
Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1, Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated and only prequalified candidates will be invited to answer the bid. All written communication for this procedure and the following successful ones must be in English.



WORLD BANK OFFICE, Tirana

### VACANCY ANNOUNCEMENT

The World Bank Office in Tirana is seeking to employ a local Short-Term Temporary (STT) experienced Program Assistant. The incumbent is expected to perform in a demanding institution, with high professional standards. The World Bank is an important development partner of Albania, finances an extensive assistance program, and carries an active policy dialogue with the Government and other development partners.

#### Skills Required:

- A university degree or equivalent education.
- Demonstrated verbal and written communication skills, including the ability to communicate in Albanian. Excellent knowledge of written and spoken English is essential. Translation and interpretation skills would be a definite asset.
- Preference would be given to candidates with demonstrated experience as program assistants with a minimum of 2 years.
- Strong computer skills; proven ability to use standard and customized technology packages, e.g., Internet, Word, PowerPoint, Excel. Familiarity with Outlook Mail is preferable.
- Knowledge and understanding of information management, procedures and best practices, including the relevant technology and system knowledge.
- Familiarity with communications approaches, tools, and methodologies.
- Strong organizational, research/analytical and presentation skills.
- Knowledge of social, political and development issues in Albania to work closely with Sr. Communications Officer to make the service available on-line through the World Bank Country Office Website and Facebook.
- Teamwork/Collaboration skills and recognized ability to work effectively in a team-oriented environment.
- Outstanding verbal communication and interpersonal skills to interact effectively with a range of contacts internally and externally using maturity, good judgment, tact and diplomacy.
- Demonstrated skills in organizing, prioritizing, scheduling, planning and coordinating work and other activities internally and externally.
- Ability to take personal ownership and accountability to meet deadlines.

#### Terms and Conditions of Employment:

The position will be a short-term contract (up to 12 months). This position could be later converted into a longer-term contract provided the incumbent demonstrates satisfactory performance, and if an opening becomes available. Fees and benefits are highly competitive. The World Bank offers its permanent staff extensive opportunities for training and career development.

#### Applications shall include:

1. A cover letter in English, documenting the applicant's skills and qualifications for this position.
2. A copy of the University Diploma or other equivalent studies.
3. A detailed Curriculum Vitae with the names and addresses of previous employers and a description of duties and responsibilities.
4. The name, address and contact telephone number of at least two professional references from previous employers or teachers/professors (for recently graduated candidates).

All applications, including supporting documents, should be authentic and submitted to World Bank Office in a sealed envelope addressed to the Country Manager, no later than close of business July 6, 2018. Please note only short-listed candidates will receive responses within fourteen days of the job posting closing date.

Address  
World Bank Office  
"Ibrahim Rugova" Street, No. 34  
Tirana, Albania  
Tel: +355 (0) 42 280 650/51

## BalkanWebJ.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS





Tatimet këshillojnë: Shembuj për llogaritjen e sigurimeve shoqërore e shëndetësore

Ornela Manjani

# Të dypunësuarit, detyrimet për kontribute dhe përfitimet

## Tri rastet referuar pagës për të vetëpunësuarit

Drejtorja e Tatimeve në vijim të trajtimit të rasteve të punonjësve ekonomikisht aktivë në më shumë se dy subjekte ka publikuar një buletin këshillues, si më poshtë, ku ka paraqitur raste të tjera të mundshme të personave të vetëpunësuar dhe punësuar në më shumë se dy subjekte aktive. Në rastin e parë kur personi fizik i vetëpunësuar është njëkohësisht edhe i punësuar te një punëdhënës (person juridik ose person fizik), ai duhet gjithashtu të paguajë kontributet edhe si i punësuar te ky punëdhënës. Për llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve për personin e vetëpunësuar, i cili njëkohësisht është edhe punëmarrës te një punëdhënës tjetër kur paga mujore e të vetëpunësuarit si punëmarrës tek një tatimpagues tjetër është më e vogël se kufiri maksimal i pagës për kontributet shoqërore, tatimpaguesi punëdhënës (person juridik ose person fizik), ku i vetëpunësuarit është i punësuar, bën të gjitha veprimet e llogaritjes dhe deklarimit të kontributeve njësoj si për gjithë punëmarrësit e tjerë sikur personi të mos ishte edhe i vetëpunësuar. Pra, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore llogariten dhe deklarohen mbi bazën e pagës reale, por jo më pak se paga minimale në shkallë vendi. Ndërsa për kur i vetëpunësuarit, si i tillë, për vete, te personi fizik do të llogaritet dhe deklarohet kontribute shoqërore deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi, në atë masë që shuma e pagës si punëmarrës dhe paga deri në kufirin minimal si i vetëpunësuar të mos kalojë kufirin maksimal të pagës për kontributet shoqërore. Në këtë rast tek emri i tij në rubrikën "Shënime" të të dhënave të listëpagesës shënon "Deklaruar kontribute shoqërore me pagë ... te subjekti "x" me NIPT.....", si dhe ruan vërtetimin e tatimpaguesit ku është i punësuar. Për këtë rast, nga personi fizik, kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributin e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit, njësoj sikur i vetëpunësuarit të mos ishte edhe i punësuar. Në të njëjtën mënyrë, si rastet më sipër në pikën 9.3 për të vetëpunësuarin, vepron edhe për punonjësin e papaguar të familjes, i cili punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin, kur ai është edhe i punësuar në një punëdhënës.

### RASTET E ORTKATËRISË

Në rastet kur i njëjti person, ortak i vetëm, është i

### KONTRIBUTET

Kur personi fizik i vetëpunësuar është njëkohësisht edhe i punësuar te një punëdhënës (person juridik ose person fizik), ai duhet gjithashtu të paguajë kontributet edhe si i punësuar te ky punëdhënës.

regjistruar si person juridik dhe paguan kontribute si i punësuar te shoqëria, por njëkohësisht është i regjistruar edhe si person fizik, për llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve për vete vepron si më poshtë: a) Personi juridik, kontributet e sigurimeve shoqërore, për ortakun e vetëm si i punësuar i shoqërisë i llogaritet dhe deklarohen mbi pagën bruto jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi deri në nivelin e pagës maksimale për kon-



Foto ilustruese

tributet shoqëror. Kontributi i sigurimit shëndetësor llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës bruto të ortakut të vetëm si i punësuar, jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi dhe pa kufi të sipërm të saj. b) Personi fizik, për të vetëpunësuarin për vete do të llogaritet dhe deklarohet kontribute shoqërore deri në kufirin e pagës minimale në shkallë vendi, në atë masë që shuma e pagës si punëmarrës te personi juridik dhe paga deri në kufirin minimal si i vetëpunësuar të mos kalojë kufirin maksimal të pagës për kontributet shoqëror. Në këtë rast te emri i tij në rubrikën "Shënime" të të dhënave të listëpagesës, shënon "Deklaruar kontribute shoqërore me pagë .....", si dhe ruan vërtetimin e subjektit ku është

persona fizikë me ose pa punëmarrës dhe punonjësit të paguarit të familjes, të dy tatimpaguesit bëjnë llogaritjen dhe deklarimin e kontributeve të të vetëpunësuarit për vete njësoj sikur i vetëpunësuarit të mos ishte i vetëpunësuar në dy tatimpagues persona fizikë. Pra, secili prej tatimpaguesve persona fizikë, për të vetëpunësuarin, për vete, llogaritet dhe deklarohen kontributet e sigurimeve shoqërore mbi një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi e deri në atë masë sa që shuma e pagave të të dy personat fizikë të mos kalojë kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Për këtë rast, nga personi fizik, kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributin e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit. Për rastet kur gjatë muajit, një person i regjistruar si tatimpagues person fizik (i vetëpunësuar), me ose pa punëmarrës, punon edhe si punonjësi i papaguar i familjes, në një tatimpagues person fizik (i vetëpunësuar) i regjistruar në emër të familjarëve të tij, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, të dy tatimpaguesit bëjnë deklarimin e personit në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse. Personi fizik, ku i vetëpunësuarit punon si punonjësi i papaguar i familjes bën deklarimin, në drejtorinë rajonale tatimore, me të dhënat sipas rubrikave të deklarimit "Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, si dhe e të larguarve nga puna". Personi i regjistru-

ar si person fizik i vetëpunësuar, por edhe si punonjësi i papaguar i familjes në një person fizik të familjarëve të tij, pasqyrohet në të dhënat e rubrikave të listëpagesës përkatësisht nga të dyja subjektet, por llogaritja dhe deklarimi i kontributeve kryhet vetëm nga personi fizik i regjistruar në emër të personit në fjalë, si më poshtë: a) (personi fizik, për të vetëpunësuarin për vete llogaritet dhe deklarohen kontributet e sigurimeve shoqërore mbi një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi e deri në kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore. Për këtë rast kontributi i sigurimit shëndetësor të të vetëpunësuarit për vete llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës minimale për kontributin e sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit. b) Person-

deklarimi i kontributeve kryhet vetëm nga njëri prej tatimpaguesve (person fizik) i regjistruar në emër të familjarëve të tij, në nivelin e pagës minimale, sipas përkatësisë për kontributet shoqërore dhe ato shëndetësore për të vetëpunësuarit. Tatimpaguesi tjetër (person fizik) tek emri përkatës i familjarit, në rubrikat e vlerave të kontributit shoqëror dhe shëndetësor të listëpagesës vendos zero dhe në rubrikën "Shënime" të listëpagesës bën shënimin "Deklaruar kontribute si punonjësi i papaguar i familjes te personi fizik "x" me NIPT.....". d) Kur rezultoni që kontributi shoqëror në total i paguar për të njëjtin person nga të dy tatimpaguesit është më i madh se kontributi i llogarituri mbi pagën maksimale për kontributet shoqërore për të punësuarit,

### LLOGARITJET

Kontributi i sigurimit shëndetësor llogaritet dhe deklarohet mbi bazën e pagës bruto të ortakut të vetëm si i punësuar, jo më pak nga paga minimale në shkallë vendi dhe pa kufi të sipërm të saj.

ni fizik tjetër, i regjistruar në emër të familjarëve, tek i cili i vetëpunësuarit punon si punonjësi i papaguar i familjes, tek emri i tij në rubrikat e vlerave të kontributit shoqëror dhe shëndetësor të listëpagesës, vendos zero dhe në rubrikën "Shënime" të listëpagesës bën shënimin "Punonjësi i papaguar i familjes ka deklaruar kontribute te personi fizik "x" i regjistruar në emër të tij me NIPT.....". c) Për rastet kur punonjësi i papaguar i familjes (pjesëtar i familjes, që nuk trajtohet me pagë), që punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin, gjatë muajit punon në dy tatimpagues persona fizikë, të regjistruar në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, të dy tatimpaguesit bëjnë deklarimin e punonjësit të papaguarit të familjes, me të dhënat sipas rubrikave të deklarimit "Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishitazi, si dhe e të larguarve nga puna". Të dy tatimpaguesit në të dhënat e rubrikave të listëpagesës së kontributeve pasqyrojnë punonjësin e papaguarit të familjes, por llogaritja dhe

atëherë për shumën totale të kontributeve shoqërore të paguara më tepër për punonjësin e punësuar në të dy tatimpaguesit, drejtoria rajonale tatimore, mbi bazën e kërkesës së tij me shkrim, bën rimbursimin e tatimpaguesit nga i cili punonjësi ka marrë pagën më të lartë. Ky tatimpagues bën rimbursimin e punonjësit për shumën totale të pjesës së kontributeve të punëmarrësit të paguar më tepër në të dy subjektet. Veprimet e rimbursimit të kontributeve duhet të pasqyrohen në versionin e listëpagesës me të dhëna të ndryshuara, të periudhës tatimore përkatëse, e cila i kërkohet dhe duhet të deklarohet nga tatimpaguesi përkatës. Kur të dhënat e listëpagesës janë dërguar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, atëherë versioni i listëpagesës me të dhënat e ndryshuara për kontributet i dërgohet edhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

# PRANIMET NE UT INTERVISTA

Drejtori i Kurrikulës: Akreditimi periodik, jemi të besueshëm. Degët më të kërkuara

# Universiteti i Tiranës hap dyert për 5545 studentë për vitin 2018-2019

Çlirim Duro zbardh kuotat e pranimit në 6 fakultete

Voltiza Duro

Universiteti i Tiranës do të hapë dyert për 5545 studentë të rinj që do të përzgjidhen në një nga degët e studimit për vitin akademik 2018-2019. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', Çlirim Duro, drejtor i Kurrikulës në Rektoratit e këtij universiteti zbardh vendimin e miratuar në mbledhjen e fundit të senatit akademik. Sipas Duros, kuotat e pranimit në UT janë pothuajse njësoj krahasuar me një vit më parë, me diferenca shumë të vogla. Kështu në Bachelor ka rreth 86 kuota më pak se viti i kaluar; në master shkencor ka 27 më shumë dhe në master profesional rreth 52 kuota më shumë krahasuar me 2017-2018-ën. Ndërkohë drejtori i Kurrikulës bën me dije se ndër degët më të kërkuara nga maturantët janë Informatika, Drejtësia, Ekonomiku, por pa lënë pas edhe programet e studimit të Fakulteti i Shkencave Sociale e ai i Gjuhëve të Huaja. Sakaq, Duro thekson për të gjithë ata që kanë dyshime mbi njohjen e diplomës së dhënë nga Universiteti i Tiranës, se ky institucion është futur në periudhën e një akreditimi periodik dhe nuk ka asgjë për t'u shqetësuar.

**Në mbledhjen e fundit të senatit akademik të Universitetit të Tiranës u përcaktuan kuotat e pranimit për vitin akademik 2018-2019 në të 6-ta fakultetet. Sa është numri i kuotave për nivelin Bachelor dhe Master?**

Universiteti i Tiranës në mbledhjen e radhës të Senatit Akademik vendosi të miratojë kuotat për ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve, pra për Bachelor dhe për Master Shkencor dhe Profesional. Në ciklin e parë Bachelor kemi 5545 kuota; në ciklin e dytë Master i Shkencave kemi 3400 kuota dhe po në ciklin e dytë në Master Profesional, ne kemi 2667 kuota.

**Më specifikisht, sa studentë do të pranohen këtë vit në juridik, ekonomik dhe degët të tjera të shkencave sociale apo natyrore?**

Sipas vendimit më të fundit të senatit akademik,

**5545**

**KUOTA PRANIMI**

"Në ciklin e parë Bachelor ne kemi 5545 kuota; në ciklin e dytë Master i Shkencave kemi 3400 kuota dhe po në ciklin e dytë në Master Profesional, ne kemi 2667 kuota", -tha Duro.



Çlirim Duro, drejtor i Kurrikulës në Rektoratit e Universitetit të Tiranës

**700**

**PRANIME NË JURIDIK**

Në fakultetin e Drejtësisë ka 700 kuota; në Fakultetin Ekonomik, dega Administrim-Biznesi ka 460 kuota, Ekonomiksi 110 të tilla, Financa ka 460, dhe Informatikë-Ekonomike ka 250 kuota", -tha Duro.

në fakultetin e Drejtësisë ka 700 kuota; në Fakultetin Ekonomik, dega Administrim-Biznesi ka 460 kuota, Ekonomiksi 110 të tilla, Financa ka 460, dhe Informatikë-Ekonomike ka 250 kuota. Ndërkohë 180 kuota do të kenë degët Histori, Gjeografi dhe Gjuhë- Letërsi; Gazetaria ka 120; Arkeologjia ka 100 kuota pranimi. Vijomë më tej me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ku dega Biologji ka 100 kuota; Bioteknologjia po 100 të tilla; Matematika ka 100 kuota e po njësoj edhe Fizika. Po 100 studentë do të pranohen edhe në këto degë: Kimi, Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Kimi Industriale dhe Mjedisore; Teknologji Informatike si dhe Inxhinieri Matematikë dhe Informatikë. Ndërkohë Informatika do të ketë në dispozicion 200 kuota. Në Fakultetin e Shkencave Sociale, dega Psikologji ka në dispozicion 110 kuota; Punët Sociale, Sociologjia dhe Shkencat Politike, Administrim dhe Politikë Sociale do të kenë 100 studentë të rinj çdo program. Ndërsa filiali i UT në Sarandë do të ketë 75 kuota për degën Administrim Biznesi dhe Gjuha Angleze 50 kuota.

**Si paraqiten këto shifra krahasuar me vitin akademik 2017-2018-të?**

Duke i krahasuar me

shifrat e vitit të kaluar ne jemi gati njësoj me vitin e ri. Po të bëjmë një krahasim, në Bachelor ka rreth 86 kuota më pak se viti i kaluar, në Master Shkencor ka 27 më shumë dhe në Master Profesional rreth 52 kuota më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Pra, po të bëjmë një balancë në total, jemi pothuajse me të njëjtat kuota. Në bazë të ofertë- kërkesës është parë me shumë kujdes që të kemi këto kuota në bazë të kapaciteteve që Universiteti i Tiranës ofron, si në pikëpamjen infrastrukturore dhe atë akademike. Ligji i Arsimit të Lartë, na jep ne të drejtë që të përcaktojmë kuotat, e më tej Ministria e Arsimit ka të drejtë që të kryejë një inspektim për të parë nëse universiteti i plotëson kushtet për të tilla kuota studentësh.

**Cilat janë kriteret me të cilat duhet të njihen që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një nga degët e UT-së?**

Nuk është se ka ndryshime nga viti i kaluar për sa i përket kriterëve. Universiteti i Tiranës ofron programe diverse, dhe kur bëhen përlllogaritjet në bazë të notave të provimeve të maturës dhe mesatares së gjimnazit, ka disa lëndë që iu jepen më shumë prioritet. Fakultetet nuk kanë të njëjta kri-

FAKULTETI	Loji i programit të studimit	Emërtimi i programit të studimit	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda vendit
o1	Bachelor	Histori	180
o2	Bachelor	Gjeografi	180
o3	Bachelor	Gjuhë- Letërsi	180
o4	Bachelor	Gazetari	120
o5	Bachelor	Arkeologji	100
o6	Bachelor	Biologji	100
o7	Bachelor	Bioteknologji	100
o8	Bachelor	Matematikë	100
o9	Bachelor	Fizikë	100
o10	Bachelor	Informatikë	200
o11	Bachelor	Kimi	100
o12	Bachelor	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	100
o13	Bachelor	Kimi Industriale dhe Mjedisore	100
o14	Bachelor	Inxhinieri Matematikë dhe Infor	100
o15	Bachelor	Teknologji Informatike	100
o16	Bachelor	Gjuhë Angleze	240
o17	Bachelor	Gjuhë Frënge	120
o18	Bachelor	Gjuhë Gjermane	120
o19	Bachelor	Gjuhë Italiane	150
o20	Bachelor	Gjuhë Grike	90
o21	Bachelor	Gjuhë Turke	90
o22	Bachelor	Gjuhë Ruse	80
o23	Bachelor	Gjuhë Spanjolle	90
o24	Bachelor	Psikologji	110
o25	Bachelor	Punë sociale	100
o26	Bachelor	Filozofi	90
o27	Bachelor	Sociologji	100
o28	Bachelor	Shkenca Politike	100
o29	Bachelor	Administrim dhe Politika Sociale	100
o30	Bachelor	Administrim Biznes	460
o31	Bachelor	Ekonomiks	110
o32	Bachelor	Financë	460
o33	Bachelor	Informatikë Ekonomike	250
o34	Bachelor	Program i Drejtësisë	700
o35	Bachelor	Administrim Biznes	75
o36	Bachelor	Gjuhë Angleze	50
Gjithsej UT - Bachelor			5545

Faksimilë e kuotave në 6 fakultetet e UT-së për bachelor-in

kriteret edhe për vitin akademik 2019-2020 pasi kurrikula e arsimit parauniversitar (gjimnazet) kanë mbi 90% lëndë me zgjedhje dhe këto kanë peshë për të hyrë në universitet. Ne i kemi paraprirë që maturantët të zgjedhin ato lëndë që iu japin më shumë pikë për të hyrë në universitetin e Tiranës.

**Do të ketë ndryshime për tarifat e studimit në këtë universitet?**

Them me bindje se tarifat nuk janë ndryshuar! Vlen të theksoj se janë vendosur tarifa lehtësuese për të gjithë studentët në nevojë, duke iu dhënë edhe masterin gati me tarifë zero.

**Vetë maturantët në cilat programe studimi kanë shprehur më tepër interes?**

Ne kemi pasur shumë kërkesa për informacion mbi degët e studimit nga gjimnazistët, pra është një proces shumë i rëndësishëm për ne. Më shumë interes ka pasur në degët: Informatikë, Drejtësi, Ekonomik si dhe Histori, Gazetari, Gjeografi, Gjuhët e Huaja e Shkencat Sociale.

**Universiteti i Tiranës ka marrë vetëm 1 vit akreditim dhe shumë studentë janë shprehur skeptikë mbi njohjen e diplomës jo vetëm jashtë, por edhe brenda vendit. A do të ketë probleme me njohjen e diplomave të lëshuara nga UT?**

Universiteti i Tiranës është i akredituar me 1 vit e përfundon kur do të merret vendimi tjetër pasardhës. Ne jemi të besueshëm në mënyrë absolute, jemi të akredituar dhe në fillim të shtatorit të këtij viti, kemi bërë kërkesën e jemi futur në fazën e një akreditimi periodik. Kështu që të maturantët e studentët duhet të rrinë të qetë. E rëndësishme është sa vlerë ka diploma në tregun e punës!

tere për pranimet në programet e studimit. Ne kemi bërë takime me mat-

urantët dhe i kemi informuar mbi këtë. Vlen të theksoj se janë miratuar

Qendra e Shërbimeve Arsimore: Kujdes, dokumentacioni që duhet të keni në testim

# Zbardhen datat e provimit të licencës për infermierët

## Kalendari i plotë dhe oraret gjatë muajit korrik të 2018-ës

Voltiza Duro

**P**rej datës 2 korrik të këtij viti plot 2231 infermierë do t'i nënshtrohen provimit të licencës, i cili do të zhvillohet në ambientet e Qendrës së Shërbimeve Arsimore në Tiranë. 'Gazeta Shqiptare', publikon sot kalendarin me datat dhe oraret kur do të zhvillohet testi për të gjithë kandidatët aplikantë për provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të infermierit. "Ju bëjmë me dije se provimi i shtetit për profesionin e rregulluar të infermierit do të zhvillohet brenda periudhës kohore nga java e parë deri në javën e tretë të muajit korrik 2018. Provimi i shtetit do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA) me adresë: Rruga: "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë", -theksohet në njoftimin e QSHA-së. Kjo e fundit thekson për të gjithë ata që do t'i nënshtrohen testimit së ditën e provimit kandidati duhet të jetë i pajisur me letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal); kopje të Kartë ID ose Pasaportë; faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA në një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA sipas herës së pjesëmarrjes). Sipas ligjit "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" në nenin 7 theksohet se personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të stu-



### TARIFA, E PAKTHYESHME

Ndërkohë tarifa e depozituar për llogari të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pakthyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit. Kandidatët duhet të paraqiten vetëm në orarin e përcaktuar dhe publikuar në faqen web të QSHA.

dimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### RREGULLORJA GJATË TESTIMIT

Kandidati duhet të paraqitet në QSHA 30 minuta para fillimit të provimit të shtetit, duke pasur parasysh rregulloren. "Ndalohej marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi; ndalohej duhani dhe konsumimi i ushqimit; ndalohej komunikimi gjatë zhvillimit të provimit", -thekson Qendra e Shërbimeve Arsimore. Ndërkohë tarifa e depozituar për llogari të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pakthyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit. Kandidatët duhet të paraqiten vetëm në orarin e përcaktuar dhe publikuar në faqen web të QSHA. "Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni emrin, atësinë, mbiemrin, si dhe datën dhe orën e provimit në faqen zyrtare të QSHA në adresën [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al), rubrika lista e kandidatëve. Në rast pasaktësie në të dhënat e paraqitura në web, lutemi të kontaktoni në adresën [provimeshteti@outlook.com](mailto:provimeshteti@outlook.com) si dhe të njoftoni përpara se të hyri në ambientin e provimit", -nënvizohet më tej në njoftimin e QSHA-së.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT				
ORGANIZIMI I PROVIMEVE TË SHTETIT PËR PROFESIONIN E INFERMIERIT SEZONI XIV KORRIK 2018				
E hënë 02.07.2018	E martë 03.07.2018	E mërkurë 04.07.2018	E enjte 05.07.2018	E premte 06.07.2018
09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri
11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri
14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri
E hënë 09.07.2018	E martë 10.07.2018	E mërkurë 11.07.2018	E enjte 12.07.2018	E premte 13.07.2018
09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri
11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri
14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri
E hënë 16.07.2018	E martë 17.07.2018	E mërkurë 18.07.2018	E enjte 19.07.2018	E premte 20.07.2018
09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri	09:00 Infermieri
11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri	11:30 Infermieri
14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	14:00 Infermieri	11:30 Infermieri

Faksimilje e kalendarit për provimin e licencës

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**BANKA E SHQIPËRISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR NDËRKOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Upgrade i Sistemit të Regjistrimit të Kreative të Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur ndërkombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 30,000,000 Lekë ose 226,655 Euro**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Ilogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC  
Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Upgrade i sistemit të Regjistrimit të Kreative të Bankës së Shqipërisë"

Oftera duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 26 Korrik 2018, ora 09:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**BANKA E SHQIPËRISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje dhe implementim i 4 copë pajisjeve "SAN Switch" për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 27.000.000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Ilogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC  
Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje dhe implementim i 4 copë pajisjeve "SAN Switch" për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oftera duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 25 Korrik 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Babai i dy fëmijëve, kamerier i preferuar në një restorant të Nju Jorkut

# E dëbuan pas 24 vitesh në SHBA, emigranti: Nuk pashë dot as vajzat

*Kërkoj azil politik në vitin 1993, Sokol Vokshi për "New York Post": Nuk e di pse më ndodhi kështu*

Një emigrant shqiptar, i cili ka punuar për 24 vite në një restorant në Nju Jork, pretendon se nuk është lejuar që të telefonojë gruan dhe fëmijët e tij përpara se të depërtohej në muajin prill të këtij viti në Shqipëri. Bëhet fjalë për Sokol Vokshin i njohur ndryshe si "Sal". Ai ishte "kamerieri i preferuar i të gjithëve" në restorantin Golden Reef në vendin e quajtur Long Island përpara se të depërtohej. 47-vjeçari, baba i dy fëmijëve të moshës 12 dhe 14 vjeç tha se e kthen në vendlindje më 4 prill, përpara se ai të mund të shihte vajzat e tij. "Nuk e di pse më ndodhi kështu", u shpreh Vokshi për "New York Post". Vokshi që ka një shtëpi të tij në Elmton të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aktualisht ndodhet në Durrës, Shqipëri. Ndërkohë, avokati i tij, Altin Nanaj pohoi për "New York Post" se ky rast deportimi ishte i pazakontë, pasi Vokshi ishte pajisur me një numër Sigurimi Social, merite çdo vit leje pune, paguante taksa dhe nuk kishte asnjë rekord kriminal. "Ky është një burrë familjeje model, i cili punonte natë e ditë. Mesa duket Agjencia e Emigracionit dhe Dogana është pas çdokujt", tha Nanaj. Ndërsa, pronari i lokalit ku punonte 47-vjeçari tregoi se nuk e dinte çfarë të bënte kur "Sal" nuk u shfaq më punë. Klientët u merrzëtin dhe pyesnin për të. "Sal është miku, me të cilin kemi ndarë vaktet tona prej vitesh, flasin për sport, politikë, motin dhe familjet tona. Shpresoj që ai të rikthehet sërisht në SHBA", tha një klient i rregullit i tij. Një poster që varet aty tregon dy fotografi të "Sal" dhe publikon një fushatë GoFundMe të



42-vjeçari, Sokol Vokshi



Sokol Vokshi me vajzat

### DEKLARATA

Sokol Vokshi pohoi se paguan akoma 12.000 dollarë taksa për shtëpinë e tij në Long Island dhe ka deklaruar se nëse nuk i garantohet një vizë për t'u rikthyer sërisht në SHBA, gruaja dhe fëmijët e lindur në Amerikë do të kthehen në Shqipëri. "Nuk mund të ndahem në këtë mënyrë. Ëndrra jonë amerikane po kthehet në makt", tha 47-vjeçari, baba i dy vajzave 112 dhe 14 vjeç.

krijuar nga konsumatorët për të ndihmuar në mbulimin e tarifave ligjore dhe shpenzimeve të tjera. Deri më tani, më shumë se 11,600 dollarë nga 168 njerëz janë mbledhur për fondin "Get Sal

Back to the USA" të filluar nga klienti Warren Prosky më 22 prill. Sokol Vokshi sqaroi se ka kërkuar azil politik në New York që në vitin 1993. Ai u regjistrua në qeverinë federale dhe i dhanë

një numër Sigurimi Social. Kur gjykata refuzoi kërkesën e tij në 1997-n dhe i kërkuar të largohej, ai shprehet se disa avokatë që kishte punësuar i thanë të qëndronte dhe të apelonte vendimin. "Më thanë: 'Qëndro gjatë apelit. Vazhdo puno'. Unë qëndrova, punova, u martova dhe bëra fëmijë", tha Vokshi për "New York Post" nga Durrësi.

vendimin. "Më thanë: 'Qëndro gjatë apelit. Vazhdo puno'. Një veprim shkakton një tjetër. Unë qëndrova, punova, u martova dhe bëra fëmijë", pohoi Vokshi për "New York Post" nga Durrësi.

## Avokati: Vuan nga probleme mendore

### Mbajti peng djalin e tij adoleshent, gjykata lë në burg 42-vjeçarin Admir Duro

**BERAT** - Gjykata e Beratit vendosi dje masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 42-vjeçarit Admir Duro, i cili mbajti peng në banesë djalin e tij 17-vjeçar. Gjatë seancës gjyqësore, prokurori i çështjes, Olgert Rumnici i kërkoi gjykatës cilësimin si të ligjshëm të arrestimit të Duros, kërkesë e cila u pranua nga togat e zezë të Beratit. Ndërkaq, avokati mbrojtës kërkoi cilësimin e arrestimit si të paligjshëm dhe caktimin e një mase më të lehtë sigurie për shkak të gjendjes së të rëndë të shëndetit mendor të klientit të tij, gjë e cila nuk është marrë parasysh nga kryetari i trupit gjyqësor, Durim Hasa. Në sallën e gjyqit, 42-vjeçari ka shfaqur probleme me shëndetin mendor;



por për shkak të mos kryerjes së vizitave mjekësore nuk ka pasur prova për t'u paraqitur në gjykatë që dëshmojnë problemet e tij mendore. 42-vjeçari akuzohet për veprat penale: "Heqja e paligjshme e lirisë", "Dhuna në familje", "Kundërshtimi me dhunë i punonjësit të policisë" dhe "Prishja e rendit dhe qetësisë publike". Ngjarja për të cilën akuzohet Ad-

mir Duro ndodhi pak ditë më parë në lagjen "30 Vjetori". Si pas policisë, 42-vjeçari mbajti peng për orë të tëra djalin e tij, 17-vjeçar Ablert Duro nga frika se mos e braktiste. Me pas ai hipi në soletën e pallatit ku për më shumë se tri orë kundërshtoi me forcë punonjësit e policisë, i goditi me sopatë dhe hodhi tjeçulla ne drejtim të tyre, duke lënduar dy uniforma blu.

## Favorizoi ndërtimet pa leje, pranga inspektorit të policisë në Belsh

**ELBASAN** - Një inspektor policie është arrestuar nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇ-BA) në Elbasan, pasi akuzohet për veprat penale: "Shpërdorim detyre" dhe "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike". Në pranga ka përfunduar inspektori i Policisë Idajet Sina, me detyrë ndihmës specialist për Policimin në Komunitet (SPZ) në Stacionin e Policisë, Belsh, në Komisaratin e Policisë Çërrrik. Burime nga policia bënë me dije se Sina u prangos pas një hetimi disa mujor, pasi dyshohet se ka favorizuar banorë të zonës që ai mbulon në cilësimin e ndihmës specialistit për Policimin në Komunitet të kryejnë ndërtime të paligjshme. Për punonjësin e policisë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan caktoi masën e sigurisë "Arrest me burg". Në kuadër të hetimit u morën të pandehur shtetasit: S.K., D.K., Th.Ç. dhe Z.K., banorë të njësisë administrative Seferan e Belshit, zonë e cila mbulohej nga Inspektori Sina. Të katër shtetasit akuzohen për veprën penale "Ndërtim i paligjshëm". Ndërsa vijojnë hetimet për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë çështje.



### SHKURT

#### Kapet 58-vjeçari i dënuar në Turqi për trafik droge

**ELBASAN** - Forcat e policisë së Elbasanit kanë vënë në pranga një 58-vjeçar të dënuar në Turqi për trafik droge. Bëhet fjalë për shtetasin Agron Metaj, banues në këtë qytet. Mësohet se Metaj ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Ankara-Turqi, ndërsa është dënuar me 7 vjet e 6 muaj burg për veprën penale. Si pas policisë së Elbasanit, 58-vjeçari i ka mbetur për të vuajtur dhe 5 vjet e 4 muaj burg. Sipas burimeve policore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, nga autoritetet gjyqësore turke, ka ardhur letër-porosi me qëllim kapjen dhe transferimin e ekzekutimit të dënimt.

#### Shkatërrohet banda e drogës, 14 në pranga, mes tyre shqiptarë

**ITALI** - Policia e Parmës ka arrestuar 14 persona, mes tyre edhe shqiptarë, pasi akuzohet për trafik droge që kapte vlerën e 1 milionë e gjysmë euro. Mediat italiane raportojnë se 38 persona janë të dyshuar, ndërsa janë sekuestruar 23 kg drogë. Në kuadër të operacionit të koduar "Tabula Rasa" që u krye nga karabinierët e Parmës në pranga ranë 9 shtetas nga Magrebi, 4 shqiptarë dhe një italian. Ata ishin të përfshirë në aktivitetin e paligjshëm, ndërsa mes drogave shisnin edhe heroinë. "Ansa" shkruan se aktivitetin e tyre trafikantët e zhvilluan në një lagje historike të Parmës. Po ashtu thuhet se droga sigurohej nga shqiptarët, ndërsa shitej nga një grup afrikanësh. Ndërkohë, hetimet për këtë grup kriminal kishin nisur që në vitin 2016, ndërsa gjatë kësaj kohe ishin zhvilluar dy operacione.

#### Sekuestrohen 100 kg kanabis pranë kufirit, arrestohet shqiptari

**GREQI** - Një sasi prej 100 kg kanabis sativa, e cila mendohet se ka hyrë përmes kufirit shqiptarogrek është sekuestruar nga policia greke në dy operacione antidrogë. Mësohet se operacioni i parë u zhvillua në Pella, ku u ndoqën dy automjete. Një nga mjetet që u ndoq, u gjet i braktisur në një zonë bujqësore dhe pranë tij 5 çanta me 90 kg e 200 gr marijuanë. Policia greke shpalli kërkim drejtuesin e mjetit, një grek 52-vjeçar. Ndërkohë, u kap edhe makina që shërbente për kontrollin e rrugës dhe u arrestua shoferi, grek 38-vjeç. Droga ishte marrë në kufirin greko-shqiptar nga 52-vjeçari. Ndërsa në operacionin e dytë, policia sekuestroi 2 çanta me 10 pako që përmbanin 10 kg 964 gr marijuanë. Në pranga përfundoi një shqiptar 29-vjeç.

# VIP


Suplement  
Pages

E mërkurë 27 Qershor 2018 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Princi William viziton vendin ku bashkëshortja jetoi 3 vjet
- Pas Rugovës, Sali Berisha në bjeshkët ku lahen zanat...
- Ministri kosovar ofron rrogën për gjobën e Shaqirit dhe Xhakës
- Kryeministrit kanadez i bien vetullat false në konferencë për shtyp

Tuna i rikthehet muzikës, kësaj radhe në një bashkëpunim me...



Nga Ilda Bejleri tek Viola Spiro, vajzat bukuroshe të programeve sportive



Rriten temperaturat, modelja shqiptare tepër ndjellëse provokon me bikini



## "Rusi 2018",

# botërori me moderatore seksi që rriten temperaturat këtë verë

Nga Ilda Bejleri tek Viola Spiro, vajzat bukuroshe të programeve sportive

# "Rusi 2018", botërori me moderatoret seksi që rritën temperaturat këtë verë

*"Shih me sy e plas me zemër", ja drejtueset e emisioneve që nuk kanë "mëshirë" për asnjë*



Ilda Bejleri



Vilma Masha



Viola Spiro

Pamela Aliaj

**E**dhe pse Shqipëria nuk është pjesë e botërorit, kjo nuk do të thotë që shqiptarët nuk do të jenë tifozë të çmendur për skuadrën e tyre të zemrës e do t'i ndjekin me vëmendje ndeshjet. "Rusi 2018" është një ndër botërorët më të ndjekur në vend dhe kjo jo vetëm për parashikime ndeshjesh dhe komentime skuadrash e lojtarësh. Një motiv më tepër për t'i ndjekur ato janë edhe vetë moderatoret e emisioneve të ndryshme sportive. Nuk kemi se si të mos përmendim ato që tërheqin më tepër vëmendjen me pamjen e tyre dhe jo vetëm. Duke filluar nga lozonjarja Ilda Bejleri, e cila jo më kot është cilësuar si një nga femrat më provokuese. Teksa moderon një prej emisioneve sportive që transmeton çdo ditë duke sjellë gjithnjë e më shumë aromën e "Botërorit 2018", Ilda shfaqet gjithmonë e më ndjellëse. Ajo dallon nga drejtueset e tjera të emisioneve me veshjet e saj provokuese të fustaneve me ngjyra të ndezura dhe të ngjitura pas trupit apo edhe të shkurttra. Jo vetëm të ftuar-

it e mbrëmjeve, por gjithashtu edhe teleshikuesit janë përqendruar mirë tek moderatorja seksi, e cila dallon nga të tjerat me veshjet e saj seksi si edhe me kërcimin karakteristik që bën në fund të çdo mbrëmjeje kur mbyllet emisioni. Përveç saj, rendisim në vend të dytë mod-

eratoren e një emisioni tjetër të botërorit në "Vision Plus", Eva Murati. Bukuroshja 23-vjeçare vjen e thjeshtë dhe e ëmbël në veshjet e paraqitjet e saj në ekran. Mesa duket, ajo preferon më tepër ngjyrat pastel, të

cilat i japin akoma edhe më shumë ëmbëlsi moderatorës. Ndërkohë që në vend të tretë renditet një tjetër moderatore bukuroshe e TVSH-së, Viola Spiro, e cila vjen gjithnjë e më e këndshme në daljet e saj në mbrëmjet e

botërorit. Ndërkohë që nuk mbetet pa përmendur edhe moderatorja tjetër e "SuperSport", edhe pse këtë vit është pjesë e intervistave në terren apo edhe e ftuar në mbrëmjet të drejtuara nga kolegja e saj, Vilma Masha. Kjo e fundit është paraqitur gjithnjë me një veshje shumë të

përshtatshme dhe elegante. E tillë vjen bukuroshja brune, Vilma Masha në daljet e saj në emisionet e botërorit në "Digitalb", në "Ruskibar 2018". Ndërkohë që kolegja e saj, Bora Zemani, e cila ka të njëjtin rol si Vilma, në terren shfaqet sportive, ndërkohë që në daljet e saj në emisionin sportiv në "Digitalb" ajo shfaqet tepër provokuese me fustan të zi dhe tepër të shkurtër. Kujtojmë se me veshjet e tyre provokuese, Ilda Bejleri dhe Eva Murati kanë qenë më të lakuarat dhe të "sulmuarat" nga komentet e gazetarit Mustafa Nano. Por një 'sulm' i tillë nuk i ka stepur aspak vajzat. Përkundrazi, ne shohim që Ilda sidomos nuk ka reshtur së dali ashtu siç ajo preferon dhe me stilin seksi dhe ndjellës që e karakterizon, duke mos përfillur aspak komentet e të tjerëve. Ky është vetëm fillimi i një sage njemujore të daljeve të moderatorëve tona bukuroshe në ekranet shqiptare. Këtu qëndron vërtet shprehja "Shih me sy e plas me zemër", edhe pse Ilda nuk harron t'u dërgojë shpesh puthje nga rrjetet sociale ndjekësve të saj. Ky ka për të qenë vërtet një botëror shumë i nxehtë.




Eva Murati



Bora Zemani



## "EKZISTOJNË AKOMA KËTO LLOJ NUJESH?", ISH-BANORJA E 'BB' HABIT ME PYETJEN

**E**dhe pse larg Shqipërisë, ish-banorja e "Big Brother" është një nga vajzat më të komentuar në median rozë. Për jetën private të Rike Roçit nuk dihet shumë, pasi ajo është treguar shumë e rezervuar. Ndërkohë që së fundmi, Rikes i ka lindur një pyetje mjaft e habitshme. "Ekzistojnë akoma nuset me tabaka që rrinë 24 orë në shtëpi duke i bërë punët vje-hrrës? Thjesht kuriozitet! Më thoni mendimin tuaj", ka shkruar Rikja në "Instastory". C'ne një pyetje e tillë? Mbase po bëhet gati për një bashkëjetesë me partnerin dhe familjen e tij?



## PAS DASMËS "NË FSHEHTËS", JA KU ËSHTË ARRATISUR JONA SPAHIU PËR MUAJIN E MJALTIT

**V**etëm dy javë më parë, moderatoja Jona Spahi u kurorëzuan me martesë "intime", lidhjen e tyre të dashurisë. Një dasmë e cila u komentua gjerësisht në media dhe pjesë e së cilës ishin miq dhe të afërm të dyshes së njohur. Menjëherë pas dasmës, Jona dhe Frenkli kanë nisur muajin e mjalit. Ka qenë moderatoja simpatike, ajo që ka publikuar dy video në "Instastory", ku tregon pamjet nga hoteli ku ata janë akomoduar. Gjithashtu, Jona na ka treguar edhe pamjet e vendit përrallor ku po kalon muajin e mjalit së bashku me bashkëshortin e saj. Në byzlykun që mban në dorë Jona, shkruhet Ibiza dhe me siguri ky është edhe destinacioni i muajit të mjalit të dyshes së njohur. Ndërkohë që kujtojmë se moderatoja është prej disa muajsh shtatzënë në pritje të fëmijës së saj të parë me partnerin.





## TUNA I RIKTHEHET MUZIKËS, KËSAJ RADHE NË NJË BASHKËPUNIM ME...

**A**jo është një nga këngëtarët më të dashur shqiptarë, e cila u bë e famshme me hitin në bashkëpunim me Cozman, "Fenix". Tuna Sejdiu prej më shumë se një viti është larguar nga muzika, pas lindjes së djalit të saj, Tian. Por, prej disa kohësh nëpërmjet postimeve në "Instagram", ajo po përgatit projekte të reja muzikore për t'ju rikthyer muzikës. Dhe sapo postoi së fundmi një foto ku tregon se ajo po punon për një këngë të re me këngëtarin Seven Saraçi. Tuna ka publikuar në "Instastory" disa foto me Sevenin ku duket sikur po punojnë në studio për një bashkëpunim. Gjithashtu, në një nga fotot duket edhe producenti i njohur Lirian Kaçi, duke na shtuar akoma më shumë dyshimet. Jemi duke pritur hitin e radhës, me siguri që do të jetë i suksesshëm.



## RRITEN TEMPERATURAT, MODELJA SHQIPTARE TEPËR NDJELLËSE PROVOKON ME BIKINI

**N**uk është hera e parë që të tilla seksi në rrjetet sociale. Kësaj radhe, edhe pse temperaturat këtu nuk janë të favorshme për të pasur një verë të nxehtë, mjaftohemi me fotot tepër provokuese me bikini të "VIP"-ave tanë. Modelja bukurshme, Dorina Gegiçi ka postuar së fundmi një foto provokuese me rrobabanjo të bardha, që duket se po i bien nga gjoksi i tepërt. I ka çmendur të gjithë fansat edhe pse me një fytyrë engjëjlore ajo provokon me format e saj seksi prej modeleje.





# KESHILLAT

## më të mira për meshkujt, ja si mund të bëni për vete një

# FEMER

**S**humë meshkuj nuk dinë si t'i flasin një femre. Për shkak të kësaj, e gjithë jeta mund të shkojë pa tërhequr vëmendjen e asnjë femre. Këtu janë 15 këshilla për t'ju ndihmuar, që ju tregojnë se nuk jeni duke bërë gabime me femrën që dëshironi ta tërhiqni:

Ju duhet të flisni për tema "emocionale" si p.sh. kujtimet e fëmijërisë, ambiciet e ardhshme, apo pasionet e saj. Këto tema bisede do të hapin portat e saj emocionale. Femrat duan një mashkull që nuk ka frikë ta udhëheqë aty. Ndërsa jeni duke folur me një femër, duhet të merrni kontrollin e bisedës. Asnjëherë mos prisni që ajo të diktojë se për çfarë duhet të bisedoni. Kushtojini vëmendje shenjave jo verbale, ose gjesteve të saj. Nëse jeni duke qëndruar shumë afër saj, duke e bërë atë të mos ndjehet rehat... ajo do t'ju dërgojë një shenjë që lë të kuptohet. U kushtoni vëmendje atyre. Mbani mend këtë moto "i këndshëm, jo karagjoz". Femrat tërhiqen nga meshkujt që i bëjnë ato të argëtohen. Mos u përqendroni në zgjedhjen e shakave më të forta, por përqendrohuni duke u treguar atyre kënaqësi më të madhe. Ngacmo. Një nga mënyrat më të lehta për të bërë një bisedë në një nivel argëtues është që të filloni të ngacmoni, edhe pse duket sikur kjo lihet pas prej saj. Në botën e takimeve ajo që



mbetet në prapaskenë, fillon të funksionojë përsëri. Tregohu intim me të. Femrat tërhiqen nga meshkujt, që nuk kanë frikë të bëjnë një bisedë në nivel personal, intim. Shprehni opinionin tuaj rreth saj. Gratë duan të dëgjojnë mendime rreth tyre. Tregoji se çfarë respektoni tek ajo. Shmangni komplementet e tepërta. Femrat largohen nga meshkujt,

që duken sikur "jargaviten për to". Nëse jeni duke komplimentuar një femër më tepër nga ç'duhet, ajo do të mendojë se ju jeni duke u përpjekur t'i bëni përshtypje asaj, çka do të ketë efekt të kundërt. Nëse doni të dini se si të flisni me një femër në një mënyrë që nuk e bezdisni, shmangni shumë pyetje sikur po i bëni një intervistë. Në vend të kësaj jepni mendimin tuaj në lidhje me çështjet që po bisedoni. Mos harroni formulimin e pyetjeve. Në vend që ta pyesni "ku jeni rritur?" Pyeteni: "Nuk duket se je rritur këtu?". Kjo ju lejon të bëni vëzhgime rreth saj dhe të shprehni personalitetin tuaj. Mos fshihni identitetin tuaj. Mos kini frikë të flisni për çdo gjë që ju jeni i apasionuar. Asnjëherë mos i bëj komplemente për sytë e saj, pamjen, apo trupin. Thuaj diçka që e lejon atë të kuptojë se ju po e shikoni atë në një



mënyrë "seksuale". Nëse ju nuk e bëni, po i drejtoheni rrugës me dredha-dredha. Përdorimi bisedën tip "lojë" për të mbajtur argëtimin dhe humorin flirtues. Lojërat mund të jenë të mira

për të mësuar më tepër rreth saj. Mos dhuroni dorën tuaj shumë shpejt. Femrat, ashtu si dhe meshkujt, janë një sfidë. Në qoftë se ju doni të jeni interesant për një femër, bëjeni që ajo

të mendojë se është duke fituar ngadalë mbi ju. Nëse ajo mendon se ju jeni shumë i lehtë, do ta humbasë interesin. Mënyra më e mirë për të menduar se si duhet biseduar me femrat është të mendoni se çfarë lloj bisede të gjallë, me humor dhe seksuale do t'ju kënaqë. T'i flasësh një femre s'ka pse të jetë e vështirë. Vetëm duhet të jeni i vetëdijshëm për çelësin që "i ndez dhe i fik" ato. Ndiqni listën e mësipërme dhe do të keni sukses!

### ■ Bisedat

"Femrat tërhiqen nga meshkujt, që nuk kanë frikë të bëjnë një bisedë në nivel personal, intim. Shprehni opinionin tuaj rreth saj. Gratë duan të dëgjojnë mendime rreth tyre. Tregoji se çfarë respektoni tek ajo.





# BULEVARDI

## POLITIK

*Në merrni seriozisht!*

### Princi William viziton vendin ku bashkëshortja jetoi 3 vjet

Princi William viziton vendin ku ka jetuar bashkëshortja e tij, Kate për 3 vjet. Ai ka vizituar sitin arkeologjik të Jerash, një vend që daton që në shekullin e parë. Kjo ishte një vizitë e veçantë për princin William, pasi me siguri bashkëshortja e tij i ka treguar periudhën që ka jetuar në Jordani për shkak të punës së babait të saj, Michael. Kate ishte zhvendosur së bashku me familjen e saj në Jordani në vitin 1984. Kur Kate ishte 3 vjeçe së bashku me të atin dhe motrën e saj, Pippa-n kanë realizuar një foto, pikërisht në të njëjtin vend që princi William ka vizituar dje. William me siguri ka dashur t'i sjellë një kujtim tjetër Kate nga ky vend i fëmijërisë..



### Ministri kosovar ofron rrogën për gjobën e Shaqirit dhe Xhakës

Gjobat e vendosura ndaj dy lojtarëve shqiptarë nga Kosova, që përfaqësojnë Zvicrën në Kupën e Botës "Rusi 2018", duket se kanë gjetur kontribues të shumtë të gatshëm të paguajnë për shlyerjen e një pjese të tyre. Një prej tyre është edhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, Bajram Hasani ka vendosur që pagën e tij ta japë për të paguar një pjesë të gjobës së Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit, të cilët u dënuan me nga 10 mijë franga nga FIFA për shkak të gjestit të shqiponjës. Ministri që edhe vetë vjen nga Gjilani, vendlindja e Shaqirit, tha se emocionet që ata u dhanë të gjithë shqiptarëve nuk paguhen me para. "Jo se ata nuk i kanë mundësitë financiare për ta paguar një dënim të tillë, por ndjenja e krenarisë që na dhanë me golat e tyre, më bën të ndihem i detyruar që një pagë timen ta ndaj për pagesën e kësaj gjobe. Vazhdoni djema e na bëni krenarë!", - shkruan ministri Hasani.



### Pas Rugovës, Sali Berisha në bjeshkët ku lahen zanat...

sh-kryeministri Berisha ditën e fundit është distancuar disi nga politika. Gjatë kësaj fundjave Berisha ishte me familjen e tij në Bjeshkët e Rugovës. Pas Rugovës, është ndalur në një tjetër mrekulli të trojeve shqiptare. Këtë herë ish-kreu i qeverisë na ka treguar vendburimin magjik të Drinit të Bardhë. Përmes një statusi, Berisha ka treguar mbresat nga kjo vizitë. "Aty ku buron Drini i Bardhë! Vizitova mrekulli të tjera të Kosovës! Në foto jam tek gurrat ku buron, direkt nga Mali i Rusolisë, Drini i Bardhë. Roja më tha se aty çdo ditë me diell, herët në mëngjes lahen zanat, shtojzovallet që zhduken sapo shohin turistin e parë (hahaha)! Sb", shkruan Berisha.



### Kryeministrit kanadez i bien vetullat false në konferencë për shtyp

Justin Trudeau është cilësuar si një prej kryeministrave më karizmatikë dhe më të pashëm në botë. Ai është mjaft bukurosh, por kohët e fundit, ose më saktë, gjatë 24 orëve të fundit, duket se ka lanë pak nam. Ose ndoshta ka fituar më shumë popullaritet, pas një video-aksidenti që i ka ndodhur teksa ka qenë në transmetim 'live'. Atij i kanë rënë vetullat gjatë konferencës për shtyp, në krah të presidentit francez, Emmanuel Macron, në kuadër të samitit të G7. Teksa ishte duke folur, askush nuk e kishte mendjen tek fjalët, por tek vetullat e kryeministrit, të cilat ishin duke rënë. Dukej qartë që kishte vendosur një palë vetulla false, të errëta, për t'u dukur edhe më tërheqës, por ato nuk ishin ngjitur siç duhet, e për rrjedhojë, i rrëshqiten nga fytyra. Videoja është bërë menjëherë virale dhe është shpërndarë me qindra herë në internet.

## LETËR E HAPUR

# Letër e hapur kolegut Laerti Vasili

Nga Kastriot Çipi

I nderuar koleg!

Të ndoqa sot në dëgjuesën e dytë me artistë, të thirrur nga kryetari i Bashkisë Tiranë. Nuk e di a e kuptove ti, por ishe aq ekstremist, sa edhe kolegë që po i quajmë "josindikaliste", të kundërshtuan. E mban mend çfarë the? I sugjerove kryetarit të bashkisë, që po mburrej se kishte durim dhe kohë mjaftueshëm për dialog, t'i jepte fund dialogut, sepse "ne, aktorët dhe regjisorët, jemi egoistë në gjenezë". E krahasove zyrтарin e zgjedhur me votë dhe të paguar nga taksat tona, me autorin e një veprë dramatike, i cili, sipas fjalëve të tua "është i pari, sepse ne, aktorët dhe regjisorët jemi vetëm enë komunikuese". Më kujtove atë fakirin, dëshmitarin e rremë, në filmin "Përrallë nga e kaluara", që thoshte se njeriu nuk duhet të grindet me qeverinë, se ai vetë ishte thjesht një copë dru.

Nuk jam marrë me ty personalisht në daljet e mia publike, por meqë këto deklarimet e tua gjenraliste më përfshijnë edhe mua, më lejo të të them ca fjalë.

Je ankuar se kolegët të kanë fyer, nganjëherë edhe me fjalor vulgar. Ke pasur pjesërisht të drejtë. Fyerjet vulgare nuk i shkojnë askujt, jo më artistëve, aq më pak në komunikimin publik mes njëri-tjetrit. Meqë nuk të kam fyer ndonjëherë me fjalë vulgare, bej se kam të drejtën të polemizoj me ty, me argumente.

Vjet në këtë kohë, ne ishim bashkë në përpjekjen për të themeluar një sindikatë të pavarur artistësh. U bërë helm pse unë i thirra kolegët në një grup në "Viber". Më akuzove se të vodha nismën për themelimin e "Unionit të Aktorëve", që ti e kishe shpallur prej një viti në "Facebook", por nuk e kishe bërë. Nuk e ke bërë as sot, që kanë kaluar dy vjet dhe nuk do ta bësh dot kurrë, për arsyt që do t'i shtjelloj më poshtë.

Volle për mua në grup sa i neverite të gjithë. Megjithatë, të fova në dy mbledhje e para që bëmë. Në mbledhjen e tretë, atë në të cilën u bënë zgjedhjet për kryesinë, unë nuk isha i pranishëm. Kolegët vendosën me vota të fshehta që unë të isha një nga gjashtë anëtarët e kryesisë, ndërsa ti jo. Ti këtë nuk e gëlltitte dot. Të tjera fotografime (screenshot) të mesazheve "Viber" qarkulluan nëpër grupe e komunikime dyshe.

Më 8 shkurt, u mblodhëm në Akademinë e Arteve, për të kundërshtuar projektligjin "Për Artin dhe Kulturën" dhe zhen-



"Ndonjëri ka dashur edhe të të rrahë (nuk e di pse ti ua zgjon shumë njerëzve këtë dëshirë)"

## DEKLARATA

"Nga anët tona (Delvina) thonë se mushka nuk kalon dy herë nga i njëjti shkëmb i thyer". Meqë kishe konkurruar një herë në 2014-n, ti the se nuk kishte kuptim të konkurroje sërish. Por dy ditë më pas doli se mushka ishte në fakt gomar dhe kishte kaluar sërish nga i njëjti shkëmb i thyer. Ti shpalle në "Facebook" kandidaturën tënde për drejtor të TK dhe largimin nga sindikata.

dosjen e Teatrit Kombëtar tek "Turbina". I kërkua ministres Kumbaro takim të hapur në sallën e Teatrit Kombëtar. Formulua shpejt e shpejt një peticion dhe të ftova ty, pikërisht ty, "armikun tim" ta lexoje tekstin para kamerave.

Të ftova në çdo takim të përbashkët të sindikatave në vijim, edhe në atë të fundit ku ti more pjesë, ditën kur prisim ministren Kumbaro, në sallën e TK, në ora 4 pasdite. Ishe me ne deri në ora 2 pasdite. U ndamë të gjithë duke thënë se askush nuk do të shkonte në ministri dhe se takimi duhej të zhvillohej patjetër në teatër. Atë mbrëmje ne ishim të gjithë në teatër. Salla ishte plot. Ndërsa ti, pa i thënë askujt, asnjë fjalë, shkove në ministri. Shumë vetë të kanë sharë atë mbrëmje, jo publikisht, ndonjëri ka dashur edhe të të rrahë (nuk e di pse ti ua zgjon shumë njerëzve këtë dëshirë).

Atë mbrëmje ishim sërish bashkë në studion e "Opinion" në TV "Klan". Ishe ulur përkrah meje, por e dija se nuk ishe më me mua dhe kolegët e tjerë dhe nuk u habita, thjesht u neverita, kur nise t'i recitoje poezi

dashurie ministres, që nuk është as shumë e re, as shumë e bukur. Nuk u habita as që mora vesh aty se ti paskëshe qenë i pranishëm në një darkë, me ministren e kryebashkiakun, në janar 2017, ku madje është thënë edhe emri i arkitektit Bjarke Ingels, si projektues i Teatrit të ri Kombëtar. Ky është tipi yt dhe tipat si yti ftohen në darka të tilla. Në atë darkë nuk mund të isha i ftuar unë, mistreci, kritizeri, anti-Rama.

Të nesërmen ishe sërish në "Klan", këtë herë të "Zonë e Lirë". Fole prapë kundër ministresë, projektligjit, zhvendosjes së TK tek "Turbina". Çani të pyeti nëse do të konkurroje për drejtor të TK dhe ti u përgjigje: "Nga anët tona (Delvina) thonë se mushka nuk kalon dy herë nga i njëjti shkëmb i thyer". Meqë kishe konkurruar një herë në 2014-n, ti the se nuk kishte kuptim të konkurroje sërish.

Por dy ditë më pas doli se mushka ishte në fakt gomar dhe kishte kaluar sërish nga i njëjti shkëmb i thyer. Ti shpalle në "Facebook" kandidaturën tënde për drejtor të TK dhe largimin nga sindikata. Konkursi ishte po

aq fals sa edhe ai i 2014-s dhe ti dole gomari i vetëm në këtë histori, i vetmi që mori pjesë në të dy konkurset dhe nuk fitoi. (Nëse e merr për

Nuk mund t'u thuash kolegëve se marrin urdhra partie për të protestuar në mbrojtje të Teatrit. Të paktën jo ti, që në tri vite ke ndërruar tri parti. Kalove nga Syriza tek LSI dhe u justifikove se kanë të njëjtin program. Po pres të thuash se për të njëjtin arsye ke kaluar nga LSI tek PS.

fyerje fjalën "gomar" në fjalinë e fundit, të lutem zëvendësoje me mendje me fjalën "mushkë"). U zhgënjëve e u mërzite shumë, pasi ti ishe avokati i parë dhe më

i flakti i projektit të Ingels, qysh ditën e prezantimit të tij nga Rama në kryeministri. Por unë ta thashë atëherë se Çuli do të fitonte sërish, sepse "nuk ndërrohen kuajt në mes të garës". Gjithsesi, mushkë, gomar apo kalë, sa ka jetë, ka edhe shpresë. Këto ditë Ministria e Kulturës do të shpallë konkurs për drejtorin e Teatrit Kombëtar Eksperimental. Provoje edhe një herë fatin, e treta e vërteta, thoshim kur ishim të vegjël. Jetëshkrimi yt prej artisti që ka 20 vjet që pushton skenat e Europës dhe avokatia e zjarrtë që po i bën edhe projektligjit për shembjen e TK e meritojnë një shpërblim.

Vetëm se respektin për kolegët duhet ta ruash, nëse ke ndërmend të rrihsh gjatë në këtë vend. Nuk mund t'u thuash kolegëve se marrin urdhra partie për të protestuar në mbrojtje të Teatrit. Të paktën jo ti, që në tri vite ke ndërruar tri parti. Kalove nga Syriza tek LSI dhe u justifikove se kanë të njëjtin program. Po pres të thuash se për të njëjtin arsye ke kaluar nga LSI tek PS.

Për ta mbyllur me kaq, koleg, dua të të jap një këshillë, nëse ma pranon. Ke jetuar 20 vjet në Greqi. U ktheve përgjithmonë në Shqipëri, siç më ke thënë. Mos ia mbyll portat vetes. Nuk do të doja të detyrohesh të ktheheshe sërish në Greqi, as të emigroje në dhe të huaj, që nuk e ke as të babës e as të nënës.

Sado ta quash veten "enë komunikuese", je person publik dhe deklaratat e tua

Më akuzove se të vodha nismën për themelimin e "Unionit të Aktorëve", që ti e kishe shpallur prej një viti në "Facebook", por nuk e kishe bërë. Nuk e ke bërë as sot, që kanë kaluar dy vjet dhe nuk do ta bësh dot kurrë, për arsyt që do t'i shtjelloj më poshtë.

kanë audiencë. Është e turpshme të deklarosh në media se "Racizmi në Shqipëri është më i egër se në Greqi". Në Greqi, nëse duhen besuar thënie të tua, të rrethuan teatrin ekstremistët e djathtë, donin të të digjinin të gjallë, ty dhe kolegët e tu. Në Shqipëri, e shumta të thonë ndonjë fjalë nga ato që nuk konsiderohen politikisht korrekte për të cilësuar një pjesë të komunitetit LGBT.

Sinqerisht



# “ALEKSANDRIA RA” Udha e panjohur e shiut te librat e Bibliotekës Kombëtare, Asllani: Jam e dëshpëruar...

Fatmira Nikolli

Unë mbaj dësh përimin tim për këtë që ka ndodhur, për fatin dhe situatën e rëndë në të cilën është lënë trashëgimia. Ky është problem i të gjithëve dhe përgjegjësi morale e të gjithëve”.

Persida Asllani u gjend ngushtë dje para mediave, kur duhej të thoshte se ajo dhe punonjësit e saj po bëjnë maksimumin për të shpëtuar librat e lagur nga shiu e njëherësh duhej të mohonte se ka dijeni pse erdhi përmytja.

Ka mjaftuar një rrebesh shiu që mungesin e 23 qershorit, kati më i fundëm i Bibliotekës Kombëtare, 13 metra nën tokë të gjendej i përmytur nga punonjësit e saj. Uji që ka mbërritur 2-3 cm lartësi ka dëmtuar 12 mijë njësi bibliotekare. Ngjarja është e pazakontë dhe ndodh për herë të parë. Dje para mediave, drejtoresha Persida Asllani dukej pothuaj e ‘dorëzuar’ tekta përballje me “97-ën” e shkërmoqjes së institucioneve të kulturës, në të cilat nuk është vënë dore prej kur nuk mbahet mend. Para mediave, ajo mundi vetëm të përsërisë komunikatën e një dite më parë. Mbetet e panjohur ‘udha’ që ka përshkuar uji deri në metrën e 13 nën tokë ku ruhen njësitë e Bibliotekës Kombëtare, të vendit që thotë se ka kulturën si pasaportë.

Ndonëse vit pas viti, në secilën intervistë të dhënë Persida Asllani e paraardhësit e saj kanë folur për nevojën urgjente të restaurimit të godinës, e gjetjes së më shumë hapësirave, u desh përmytja që të kuptohej se “Aleksandria ra”. Asllani dje nuk kish shumë për thënë. Hetimi duket se nuk ka nisur ende. Si të mos mjaftonte, në të katërtën ditë pas përmytjes, kur librat po thahen me tharëse flokësh e letra kuzhine, ende nuk ka një raport se nga hyri uji, pse erdhi përmytja, kush është fajtor, çfarë ka ndikuar në depërtimin e ujit në hapësirat e nëndheshme të BK-së.

Katër ditë më vonë, drejtoresha Asllani flet për vënien raportesh mes saj dhe institucioneve përkatëse profesionale që do të gjëjnë


fajin dhe faktorin.

Katër ditë më vonë, ende nuk ka përgjigje, nëse janë punimet që po bëhen në shesh që kanë dëmtuar kanalizimet a kolektorët e ujërave të bardha e të zeza që lidhin sheshin ‘Skënderbej’ me Bibliotekën që gjendet në krah të tij. Nuk dihet as nëse uji ka hyrë nga ana e Operës, nga ana e sheshit, apo nga krahu i xhamisë. Katër ditë më pas, ka vetëm pasoja, por jo shkaqe.

### KONFERENCA

Konferenca për mediat u lajmërua në drekë dhe u mbajt në orën 15:00. Me të dalë para kamerave, Asllani citoi komunikatën e një dite më parë, ku thuhej se numri i njëjësive të prekura nga lagështira është 12 mijë. “75% e librave të dëmtuar janë tharë, po punohet për pjesën e mbetur. Natyra e teksteve të lagura është e 15 viteve të fundit, janë libra shkollorë, letërsi, të cilat për shkak të mungesave të hapësirës nuk kanë mundur të ruhen sipas standardeve. Puna që po kryhet për tharjen e tyre bazohet te udhëzuesit profesional botëror, edhe pse mund të shihni letra kuzhine dhe tharësve flokësh, janë respektuar standardet. Po punohet me shpejtësi dhe ka një sasi pune të konsiderueshme. Janë marrë masa për vendosjen e materialeve në një mjedis të thatë, me aspirim, kemi hapur dritaret dhe kemi përdorur ventilator apo edhe tharëse flokësh. Situata është tërësisht nën kontroll”. Kur mirëpritur pyetjet, Asllani nuk i kishte përgjigjet.

E pyetur për shkaqet, ajo tha se “as unë e askush në



Bibliotekën Kombëtare nuk e ka ekspertizën për t’i dhënë përgjigje pyetjes suaj. Për këtë, duke pasur të njëjtin shqetësim ne u jemi drejtuar strukturave profesionale, që njihen institucionalisht, për të sjellë ekspertizën e tyre për të kuptuar cka ndodhur. Deri para 3 ditësh nuk ka pasur raste përmytjesh. Ende nuk e kuptojmë, nuk shohim rrjedhje anësore uji, por shohim lagështirë në

tirë të kuptojmë. Do presim gjykimin e ekspertëve”, tha ajo para mediave. Theksoi me këtë rast, pas pyetjeve se, BK nuk është në standardet e duhura, gjë që është çështje e ngritur vazhdimisht. “BK është jashtë çdo standardi. Po punojmë në rrethana e në kushte të vështira njerëzore e profesionale”. Pas interesimit të medias, ajo tha se uji ka hyrë në atë që është kuota më e ulët e BK, kati më i nëndheshëm, 13 metra

nën tokë e nga sa kuptohet nga gjurmët, ka arritur lartësinë 2-3 cm. “Në bibliotekë nuk duhet të hyjë uji, ndaj nuk kemi si marrim masa. Kemi marrë masa që në rast se do të ketë një depërtim të dytë të ujit, librat të mos lagen më. I kemi lëvizur prejaty”, tha ajo. E pyetur nëse uji ka hyrë nga punimet në shesh, Asllani tha: “Nuk e kemi ekspertizën për të gjykuar rreth kësaj gjëje. I jemi drejtuar Institutit të

Ndërtimit për të sjellë ekspertizën e tyre”, tha Asllani. Pyetjes nëse grupi i punës ka ardhur dhe çfarë ka konstatuar, Asllani iu përgjigj se, “kemi nisur marrëdhëniet e punës me ta. Presim në ditët që vijnë që puna e tyre të thellohet dhe të në vijë një ekspertizë”. Pas pyetjeve të mëtejshme, u mësu se në fakt, takimet me Institutin e Ndërtimit sapo kanë nisur. “Kanë filluar raportet e bashkëpunimit me ta. Sot ka ardhur drejtori i institutit, në ditët në vijim vjen grupi i punës”.

E pyetur nëse vetë ajo ndjen përgjegjësi, Asllani tha: “Kur të gjendet shkak, do gjendet përgjegjësia. Moralisht? Ju mendoj nëse kam përgjegjësi për një ndërtesë si BK? Unë përgjigjem për mbarëvajtjen e institucionit dhe si unë punonjësit kanë 72 orë për t’i bërë sa më të lehta dëmet. Zgjidhja do të ishte një bibliotekë e re, një godinë e re. Është e domosdoshme. Është i domosdoshëm ndërtimi i Bibliotekës së Tiranës, bashkia e këshilli bashkiak duhet të mendojnë për trashëgiminë kulturore të qytetit”, tha ajo.

### REAGIMI I

#### PREZIDENTIT

Përmes një deklarate ka ardhur edhe reagimi i Presidentit të Republikës, Ilir Meta. Në të thuhet se Presidenti “po ndjek me shqetësim situatën dhe është në komunikim me drejtoreshën e Bibliotekës Kombëtare”. Në vijimësi kabineti i tij po ndjek nga afër situatën dhe është në komunikim me drejtoreshën e Bibliotekës Kombëtare”. Në reagim Presidenti i Republikës u bën thirrje institucioneve përgjegjëse të marrin masa urgjente në mënyrë që të parandalojnë përsëritjen e një situatë të ngjashme në të ardhmen. “Duke kërkuar mirëkuptimin e të gjithë faktorëve politikë, socialë e mediaticë, Presidenti bën thirrje që të gjithë bashkë të kontribuojmë për të ruajtur vlerat e pasura të fondeve të Bibliotekës sonë Kombëtare”, përfundon deklarata.

Ekskluzive në "GSH"

# Bashkimi Evropian dhe korrupsioni në Kosovë

Nga Rexhep Qosja

(vijon nga faqja 1)

...korrupsionit!

Siç po shihet, në Kosovë sot kemi:

1. Këshill kombëtar kundër korrupsionit.
2. Agjenci kundër korrupsionit.
3. Javë të luftës kundër korrupsionit.
4. Luftë kundër korrupsionit.


Por, nuk kemi as Këshill, as Agjenci, as Javë, as Luftë kundër nepotizmit, megjithëse nepotizmi është një përbërës i korrupsionit me pasoja të mëdha politike, administrative, shtetërore e morale në jetën shoqërore në Kosovë.

Në Këshillin kombëtar kundër korrupsionit dhe në Agjencinë kundër korrupsionit marrin pjesë, sigurisht të emëruar prej institucioneve të larta shtetërore, anëtarë të partive, për të cilët, pothuajse nuk dihet se si, në ç'mënyrë, me çka e luftojnë korrupsionin!

Në Javën kundër korrupsionit, përpos përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, marrin pjesë kur e kur edhe ambasadorë të huaj në Kosovë. Kështu, fjala vjen, në Javën e fundit të kësaj luftime kundër korrupsionit, mori pjesë edhe Ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Greg Delavi. Me këtë rast ai e tha edhe një fjalë shumë të rëndësishme: *Lufta kundër korrupsionit është më rëndësia shumë të madhe për Kosovën.*

Në Luftën kundër korrupsionit, që s'është vetëm e Këshillit, as vetëm e Agjencisë, as vetëm e Javës, as vetëm mujore a vjetore, por "e përhershme", thonë zyrtarët e Kosovës, por mosekzistuese, thonë qytetarët e Kosovës, marrin pjesë edhe disa përfaqësues të organizatave joqeveritare të Kosovës, edhe ndonjë intelektual, edhe ndonjë diplomat i huaj në Kosovë, por ndodh të marrë pjesë, ç'është e vërteta mjaft rrallë, edhe ndonjëri prej zyrtarëve të lartë të Kosovës. Kështu, fjala vjen, njëri prej tyre, që para disa ditësh mori pjesë në këtë luftë kundër korrupsionit, deklaroi se "lufta kundër korrupsionit është axhendë e jona e përditshme", në të vërtetë axhendë e asnjëditshme e pushtetarëve, u përgjigj një gazetar zësiterrur!

Por çka është edhe më e rëndësishme për Kosovën, në këtë Luftë të përhershme kundër korrupsionit në Kosovë, në të cilën përmbledhen edhe lufta e Këshillit, edhe lufta e Agjencisë, edhe lufta e Javës, edhe lufta mujore e edhe lufta vje-



tove kundër korrupsionit në Kosovë, marrin pjesë edhe përfaqësues të Bashkimit Evropian. Dhe, marrin pjesë në këtë luftë kundër korrupsionit në Kosovë me mendime më pak a më shumë të ndryshme. Kështu, fjala vjen, njëri prej tyre korrupsionin në Kosovë e ka quajtur korrupsion pandemik; një tjetër e ka quajtur kancer politik e shtetëror, kurse një i tretë, shumë kohë para këtyre të dyve, e ka quajtur tradhti ndaj popullit.

Dhe, me gjithë luftën e Këshillit kosovar për luftën kundër korrupsionit, dhe me gjithë luftën e Agjencisë kosovare kundër korrupsionit, dhe me gjithë luftën e Javës kosovare kundër korrupsionit, dhe me gjithë këtë luftë të "përditshme" të Luftës kundër korrupsionit, dhe me gjithë pjesëmarrjen në këtë Luftë heroike kundër korrupsionit të një vargu përfaqësuesve të një vargu njerëzish politikë, të disa zyrtarëve të parë politikë e shtetërorë, të disa diplomatëve të huaj në Kosovë dhe, më në fund, të disa autoriteteve të larta të Bashkimit Evropian, korrupsioni në Kosovë vazhdon të lulëzojë, vazhdon të jetë herë epidemik e herë pandemik, vazhdon të shtrihet gjerë, të depërtojë thellë e të ngrihet lart, deri në lartësitë më të mëdha politike e shtetërore të Kosovës!

Pse? Pse? Pse?

Pse kjo luftë kundër korrupsionit në Kosovë është kështu e pafrytë, e parezultate, e kotë? E mjerë?

E para, sepse është luftë e rre-

shme, demagogjike, mashtruese ndaj popullit!

E dyta, sepse është luftë me iluzione përfutuese retorike e patetike atdhetare e të pushtetshmëve dhe e të papushtetshmëve!

E treta, sepse është luftë në thellbin e saj e sabotuar prej të gjithë pushtetshmëve dhe e të gjithëfuqishmëve të Kosovës dhe është e sabotuar prej tyre, sepse ata janë të frikësuar se po të bëhej kjo luftë kundër korrupsionit kur duhet, ku duhet, si duhet e me çka duhet ata të mund të ishin shpallur të kryekorruptuar e Kosovës.

E katërta, sepse është luftë në thellbin e politizuar, sa për sy e faqe, e autoriteteve të Bashkimit Evropian. Po të mos ishte e tillë, po të mos ishte e politizuar, po të mos ishte e disafytyrshme sjellja e tij, EULEX-i nuk do të pësonte disfatë pothuaj komprometuese në Kosovë! Po të mos ishte kështu, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Rori Okonell, betejën e tij disamujore kundër të keqes së madhe të quajtur nepotizëm nuk do ta heshtte përnjëherë dhe tani të shihet aq shpesh në shoqëri e në gosti me politikanët, përfutuesit dhe zbatuesit e shquar të nepotizmit në Kosovë!

Autoritetet e Bashkimit Evropian, po deshën ta luftojnë singërisht, po deshën ta luftojnë vendosmërisht korrupsionin (dhe nepotizmin) në Kosovë, nuk e kanë aspak të vështirë: do të duhet të bëjnë në këtë luftë çka bëjnë në vendet e tyre. Ata e dinë mirë se korrupsioni (e nepotizmi) nuk parandalohen, nuk pakësohen,

nuk çrrënjosen duke burgosur për korrupsion pylltarë, infermierë, kamerierë, mësues në fshatra e qyteza, korrierë partiakë e shkollorë, analfabetë e çerekintelektualë të profesioneve të ndryshme, po duke luftuar me s'ë pari korrupsionin e të gjithëpushtetshmëve e të gjithëfuqishmëve, sot 30,40 apo 50 herë më të pasur se ditën kur janë ulur në postet politike, të cilët me pasuritë e tyre e të familjarëve të tyre, me sjelljet e tyre e me disa "ligje" të tyre, në të vërtetë e kanë legalizuar korrupsionin dhe të cilët tashmë kapardisen si sundimtarë të sulltanizuar, që Kosovën e trajtojnë shtet të tyre privat!

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Zonja Natali Apostollova, fjala e së cilës tingëlton e sqarë, e bindshme dhe përshtypjebërëse, nuk ka nevojë të harxhojë shumë fjalë për korrupsionin këtu në Kosovë: Ajo do të duhet të përpigje që në Bruksel të krijohet vetëdija e përfaqësuesve të Bashkimit Evropian se për të pakësuar, për të parandaluar, për të çrrënjësuar një ditë korrupsionin në Kosovë duhet të bëhet ajo që është bërë në shtetin e saj - në Bullgari: e para, duhet të miratohet Ligji për prejardhjen e pasurive të zyrtarëve të lartë, të "peshqve të mëdhenj", në Kosovë, duke filluar prej kryetarit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit e të "peshqve të tjerë të mëdhenj e të mesëm" pas tyre; e dyta, duhet të caktohet Ligji për prejardhjen e pasurive të zyrtarëve të lartë, të "peshqve të mëdhenj", në Kosovë, duke filluar prej kryetarit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit e të "peshqve të tjerë të mëdhenj e të mesëm" pas tyre; e treta, duhet të nxirret gjyqësori kosovar prej

thonjë të kryepronarëve sulltanorë të shtetit të Kosovës!

Ç'është e vërteta Kosova ka Këshill kombëtar për luftë kundër korrupsionit, Agjenci kombëtare kundër korrupsionit, Javë të luftës kundër korrupsionit, prokuror për luftë kundër korrupsionit e shumëçka tjetër që ka të bëjë me korrupsionin, por pushteti në Kosovë sot shumë më shumë se luftë kundër korrupsionit ka gënjeshtër, mashtrim, dallavere, falsifikime, trillime, sabotime vrazhde, si, kërcënime, dhunë, zhvatje, reket, privilegje, derdhje të financave shtetërore, shantazhime që e asgjësojnë atë luftë kundër korrupsionit. Për të gjitha këto arsye Kosova ka nevojë për një prokuror të veçantë, të pavarur, me integritet të veçantë politik, profesional, moral, që puthadorësit e puthakëmbësit e të gjithë të pushtetshmëve siç është prokurorja e lavdishme rumune, Laura Kovesi, e cila me vendosmërinë e saj të pamposhtshme ka arritur t'i nxjerrë para gjykatave të kryekorrumpuarit e Rumanisë dhe t'i mbushë burgjet me ta e me të korrumpuarit të tjerë si ata. Në saj të veprimtarisë së saj si prokurorë me përgjegjshmëri e përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj drejtësisë, demokracisë dhe popullit të cilit i takon, që brenda një viti, si shkruajnë mediet evropiane, i realizon deri në njëmijë hetime të zyrtarëve shtetërorë prej të cilëve 90 përqind përfundojnë në burgje, ajo është bërë gjerësisht e njohur dhe e çmuar në Evropë e në botë. Është lartëçmuar prej Kryetarit të Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker, prej medieve të njohura si *Nju Jork Tajms* e *Gardian* dhe, më në fund, është çmuar edhe me dekoratën më të lartë të Francës: me Dekoraten e Nderit.

Vetëm ashtu, me ligj, dhe vetëm me ligj, me shtet të së drejtës dhe vetëm me shtet të së drejtës, mund të shërohet Kosova prej sëmundjes së rëndë të quajtur korrupsion (e nepotizëm), që cenon, shfytëron demokracinë tonë ende rurale, që pengon zhvillimin ekonomik, që vret shtetin social, që nxit dëshpërimin e qytetarëve ndaj shtetit dhe vendit të vet, që nxit moshërimin e arsyeshem të qytetarëve ndaj strukturave politike, partiake e shtetërore, që nxit zhvendosjen sidomos të rinjve prej Kosovës, që bëhet rëndësë, domethënë fuqi tërheqëse e krrimit të organizuar, që e përshtrih dhe e përthellon krizën morale të shoqërisë e shtetit të Kosovës! Të gjitha këto pasoja të korrupsionit janë të mjafta që ai, korrupsioni, të quhet siç e ka quajtur ai evropiani i shumëpërvojshëm: tradhti ndaj popullit.

Prishtinë, 23.6.2018

Opinion *i* Ditës

# Ofensiva e parasë kriminale

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faja 1)

... i antikitetit Hanibal Barka, i afroreshin Romës. Në vend të elefantëve, sot krimi po përdor makinë që importohen rregullisht për t'u shitur në tregun shqiptar. Vetëm se paratë e tij nuk janë thjesht përpara dyerve të ekonomisë sonë, por kanë depërtuar thellë në të. Rasti i 3.4 milionë eurove të kapur këto ditë në dy autotutura nuk është i vetmi. Kjo mënyrë sjelljeje e parave të shitjes së kanabisit sigurisht që është përdorur edhe më parë me sukses të plotë. Sasitë që ekonomia kriminale ka mundur të fusë dhe pastrojë në ekonominë tonë formale janë të frikshme. Pa dyshim ato përbëjnë një faktor serioz të mbajtjes së lekut artificialisht kaq të fortë, në krahasim me euron dhe dollarin në tregun tonë të vogël të këmbimit.

Partitë tona kryesore politike, në vend që të grinden dhe të përplasen verbërisht me njëra-tjetrën, duke u akuzuar rregullisht për lidhje krejtësisht kalle me botën e krimit e duke ndezur fantazi të sëmurura, ia vlen të bashkohen për të krijuar një front unik kundër kriminalizimit të ekonomisë sonë. Nuk janë gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar aleatët e vetëm të krimit që paguan aq lirshëm dhe fort nën dorë. Aleatë shumë të rrezikshëm po bëhen edhe zyrat e tatim-taksave nëpër rrethe, ku janë regjistruar me dhjetëra e qindra sipërmarrje me origjinë të dyshimtë të parave që qarkullojnë (një auditim i KLSH-së në Drejtorinë Rajonale të Taksave të Beratit i binte kambanës një vit e gjysmë më parë për këtë dukuri, por askush nuk u tregua i aftë të dëgjonte dhe kuptonte).

Nëse do të kishte ndonjë detektor (zbulues) që të ndizte llambën e kuqe aty ku futen dhe pastrohet deri sot qetësisht paratë, do të ndizej fort tek zyrat noteriale, që formalizojnë blerje pas blerjesh pronash të patundshme, apartamentesh, hotelesh, motelesh, butikësh. Janë me dhjetëra mijëra transakcione, një pjesë e mirë e të cilave sjellin dhe pastrojnë paranë kriminale tek ne. Asnjë kontroll shembullor nga ana e Ministrisë së Drejtësisë pranë këtyre dhjetëra e dhjetëra zyrate noteriale që punojnë pareshtrur edhe për krimin, si një lavatriçe "profesionale" që nuk ndryshket kurrë, në vijë të parë të ofensivës së parave të kanabisit. Asnjë rast, të paktën i deklaruar si i dyshimtë. Mbi bazën e këtyre kontratave noteriale, bankat e nivelit të dytë japin kredi për "blerësit" e formalizuar nga noterët tanë.

Dhe ka me dhjetëra, në mos qindra blerës, tashmë kredimarrës të rregullt e "të denjë" të bankave të nivelit të dytë, që tundi orët dhe zinxhirët e florinjta



rreth qafës, të sigurt se paraja e tyre e kanabisit apo prostitucionit në kryeqytet e qytetet e mëdha të vendeve perëndimore nuk bie më erë, kështu e "nusëruar" me vula noterësh dhe firma oficerësh krediti ban-

kar në truallin tonë. Janë pikërisht këta ish-"ustallarë" të krimit dhe tani "baronë" të qetë e të patrazuar të moteleve, hoteleve, bujtinave dhe butikëve buzë detit apo edhe në palcë të qyteteve tona kryesore, që trembin sipërmarr-

rësit seriozë dhe kompanitë me emër perëndimore që të installohen bindshëm tek ne. Ja përse nuk kemi dhe as që do të kemi ndonjëherë investime të forta në sektorë shërbimesh dhe në turizëm, pasi aty "thundra" e rëndë e krimit, e maskuar me transakcione nga më krijueset ka një duhmë asfiksuese. Do të jemi gjithnjë republikë bananesh, nëse nuk do të mundim të ngremë një grup pune të përshëm, një ekip profesionistësh ekonomistë e juristë të zotë, që të realizojë një skaner të fortë dhe të thellë të gjurmimit të origjinës së parave dhe transakcioneve (shitblerjeve, kalimeve të dyshimta të pronësive në SHPK e SHA, kontratave absurde të dhurimit, etj.) të 10 viteve të fundit. Për këtë duhet të punojnë fort politikanët tanë, jo të çirren dhe luajnë teatër çdo të enjte në skenën e ligjvënësit, të kthyer në "dopo lavoro (gëtitim pas pune)" për shqiptarët.

Partitë tona kryesore politike, në vend që të grinden dhe të përplasen verbërisht me njëra-tjetrën, duke u akuzuar rregullisht për lidhje krejtësisht kalle me botën e krimit e duke ndezur fantazi të sëmurura, ia vlen të bashkohen për të krijuar një front unik kundër kriminalizimit të ekonomisë sonë. Nuk janë gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar aleatët e vetëm të krimit që paguan aq lirshëm dhe fort nën dorë. Aleatë shumë të rrezikshëm po bëhen edhe zyrat e tatim-taksave nëpër rrethe, ku janë regjistruar me dhjetëra e qindra sipërmarrje me origjinë të dyshimtë të parave.

## HOROSKOPI

### DASHI

Hëna është në harmoni me Marsin, Merkurin, Uranin dhe Jupiterin. Priten surpriza të këndshme në punë. Ata që deri dje ju kundërshtonin, nga sot do t'ju mbështesin. Në dashuri mos u frikësoni nga përballjet sfiduese, nga disa probleme të brendshme do të dilni fitimtar.

### DEMI

Në punën tuaj çdo gjë do shkojë mirë dhe do të keni mundësinë të tregoni aftësitë tuaja. Do të ndërmerri një hap vendimtar për të zgjidhur një problem. Do të merrni një ndihmë të vazhdueshme, si shpirtërore, ashtu edhe ekonomike nga personat që ju duan të mirën.

### BINJAKET

Do të keni ngadalësim të aktiviteteve që i keni për zemër, për shkak të problemeve dhe pengesave të bezdisshme. Mos u dekurajoni, do kaloni shpejt. Marsi vazhdon të jetë armiqësor ndaj jush. Kujdesuni për shëndetin dhe jini më të kujdesshëm se zakonisht.

### GAFORJA

Vazhdon të ndjehet ndikimi i Saturnit që krijon kërcënime të vogla, duke frenuar dhe penguar herë pas here planet tuaja. Nëse ndjeheni të lodhur dhe të bezdisur, kërkoni shoqërinë e një mikui dhe mendimet e zymta do zduken shpejt.

### LUANI

Të jetosh jetën në mënyrë konkrete nuk do të thotë të mos keni ëndrra në sirtar, për t'i nxjerrë pikërisht në momentin e duhur! Mos i merrni shumë seriozisht disa fjalë që ju janë thënë në një moment acarimi. Jini më lartë se kaq.

### VIRGJERESHA

Mërkuri dhe Venusi në anën tuaj do t'ju ndihmojnë, duke garantuar rezultate shumë premtuese në punë dhe përvoja të bukura në jetën private. Nëse nuk jeni të lidhur, përgatituni për takime intriguese, planeti i dashurisë po thur plane për ju.

### PESHORJA

Mundësi për zhvendosjeje edhe të shkurtra nuk do t'ju vënë përpara vështirësive, por do t'ju japin ngjyra aventurash të reja gjithçkaje që do të realizoni. Ju nuk duhet të bëni gjë tjetër veçse të ndiqni rrymën, duke mos u kthyer mbrapsht për asnjë arsye në botë.

### AKREPI

Keni pak lodhje, ndaj së cilës duhet t'i kundërpërgjigjeni me ushqim e duhur, të pasur në energji dhe të shëndetshëm si mjalti dhe çokolata. Do të rigjeni entuziazmin e humbur, duke menduar për një detyrë të rëndësishme, që me shumë mundësi do t'ju besohet juve.

### SHIGJETARI

Jupiteri vazhdon t'ju mbështetë, duke ju sjellë entuziazëm dhe duke favorizuar perspektiva pozitive. Do të përjetoni momente emocionuese me partnerin tuaj. Është mirë t'ju jepni rëndësi anëve praktike të jetës së përditshme dhe rezultateve konkrete.

### BRICJAPI

Forca e vullnetit për të luftuar kundër mullinjve të erës është duke u shpërdorur. Prandaj, më mirë të ndaleni dhe të shkoni se çfarë bëhet përreth përpara se të vazhdoni. Nga njëra anë ndiheni të përjashtuar e kështu doni të çlirohni, nga ana tjetër keni dëshirë të mbahni me të katra.

### UJORI

Grindjet dhe sherrat mund të jenë gjëra që priten, por ju, me urreni do t'i mënjoni shoqërimet me persona që ju shkaktojnë tensione dhe stres. Përfitoni nga përvoja për të mos bërë të njëjtat gabime si në të kaluarën, për t'ju hapur rrugë mundësive të reja.

### PESHQIT

Planetët këshillojnë një dozë shtesë përmbajtjeje, në mënyrë që të mbani për vete disa sekrete. T'u hapeni të tjerëve gjithandaj nuk do të ishte gjë e zgjuar. Mund të konstatoni se besimi që keni tek disa persona të njohur së fundmi nuk ka qenë i arsyeshëm.



Një 0-0 shumë i shëmtuar

Franca dhe Danimarka dhurojnë "biskotën" e parë në këtë botëror

Kështu mbyllet ndeshja Danimarkë-Francë, me tifozët që kontestojnë atë që u dha në fushën e lojës nga të dyja ekipet dhe që nuk kënaqi aspak pritshmëritë e 80 mijë të pranishmëve në "Luzhniki të Moskës", që në vend të një ndeshjeje të vërtetë futbollit, shijuan "biskotën" e parë të kësaj Kupe Bote. Deshamp bën turnover dhe në lë stol Loris, Pogba, Matuidi, Mbape

dhe Umtiti, ndërsa në 45 minutat e para ka më shumë aksion dhe më shumë ritëm. Danimarka e nis vullshëm, por Franca krijon e para me Zhirun, gjuajtjet e të cilit e nxjerr sipër traverse Shmajkëll. Vikingët kërcënojnë

seriozisht në minutën e 30-të, kur Kornelius harkon nga e majta, por Eriksen nuk arrin të godasë siç duhet. Më pas janë "gjelat" më prezentë në rrethimin e 16 metrave të Danimarkës, me Dembelen që gjuan jashtë e

më pas me Grizmanin që fillimisht shërben për Zhirun e më pas pengohet nga Jorgensen, që ndal me faull një aksion të rrezikshëm. Pjesa e parë përfundon me rrjeta të paprekura, ndërsa e dyta do të bjerë në

qetësi të plotë sapo në Soçi Peruja shënon golin e dytë ndaj Australisë, duke nxjerrë "kangurët" jashtë pretendimeve. Ndonëse skuadrat krijojnë raste sporadike në gjysmën e parë të pjesës së dytë, në fundin e saj do të shuhen ngadalë duke mbajtur një barazim që nuk prish ekuilibrat në grupin C dhe lejon të dyja ekipet të shkojnë në fazën e 1/8-ave pa shpenzuar energji të tjera.

Leo Mesi rilind në ndeshjen kyçe, shënon dhe çon para "Albiselesten" në këtë Kupë Bote

Kroacia "fundos" Islandën, Argjentina kualifikohet!

Ç'mëkat për Nigerinë! Ëndrra ishte pranë



Jeton Selimi

Kroacia i jep leksion Francës. I jep leksion Danimarkës dhe të gjithë botës së futbollit. Ballkanasit, ndonëse të kualifikuar dhe me 9 titullarë të lënë pushim nga Zlatko Daliç, japin maksimumin përballë Islandës duke ndërprerë ëndrrën e madhe të një kombi të vogël, por që në pak vjet ka dhënë shpirtin për futbollin. Por nëse dikush qan, një tjetër qan më fort, por nga gëzimi dhe ajo është Argjentina.

Ndeshja në "Rostov Arena" Kroacia dhe Islanda luajnë futboll. Nordikët e nisin ndeshjen më mirë, madje krijojnë shumë raste shëni mi për të kulmuar në fundin e fraksionit të parë me fluturimin e Kaliniç që ndërpret golin e ishullorëve. Pjesa e parë mbyllet pa gola, por e dyta është e pasur me emozione të shumta. Milan Badelj trondit fillimisht traversën e Halldarsonit përpara se të tundë rrjetën, kur me të djathtën realizon golin e avantazhit. Islanda përpqet dhe reagon menjëherë, por Ignason ndalet nga traversa, ndërsa me kalimin e minutave ishullorët kërkojnë dëshpërimisht barazimin për ta arritur në minutën e 76-të Gyfi Suigurdson realizon nga pika e



bardhë e penalltisë. Minutat e fundit janë të hapura, por ata që i shkojnë më afër golit janë kroatët, të cilët në kohën shtesë shkatërrojnë ëndrrën e Islandës për kualifikimin, por japin një leksion të madh fair-play. Kroacia e mbyll grupin me 9

pikë, e vetmja skuadër me pikë të plota deri më tani, ndërsa Islanda e mbyll grupin me 1 pikë. Argjentina ia del të kalojë turin në frymën e fundit, me kuptimin e plotë të fjalës. Skuadra e Lionel Mesit, ka arritur mes 16 më të mirëve

të turneut falë suksesit 2-1 përballë Nigerisë dhe ndihmës që i erdhi nga Kroacia në ndeshjen tjetër. Duke se ndeshja do shkonte siç ëndërronin argjentinasit, me Mesin që shënoi shumë shpejt golin e avantazhit. Por më pas ritmi i lojës ra,

pasi dukej qartësisht se Argjentina ishte në pritje të lajmeve nga stadiumi tjetër, duke rrezikuar rrallëherë portën nigeriane. Nga përgjumja argjentinase përfitoi Nigeria me një fillim të vullshëm të pjesës së dytë, duke fituar penallti pas faullit të Masçeranos. Moses nuk gaboi nga pika e bardhë dhe rezultati 1-1 dënonte argjentinasit. Këta të fundit u hodhën me forcë në sulm, duke kërkuar me ngulim golin, sidomos pasi dëgjuan se Islanda po barazonte me kroatët. Por goli do të vinte pak minuta para fundit nga mbrojtësi Roho, i harruar në zonën kundërshtare, i cili me një goditje të shpejtë dërgoi topin në rrjetë dhe i siguroi skuadrës së tij kalimin e turit falë edhe suksesit të mëvonshëm kroat. Tani Argjentina duhet të përgatitet për sfidën e radhës, atë ndaj Francës, që është pretendente për titullin.

PERU-AUSTRALI 2-0



Peruja thyen ëndrrat e Australisë për kënaqësinë e fitoëve

Duam t'u japim një kënaqësi të fundit të gjithë fansave peruanë që kanë mbështetur gjatë këtyre ditëve". Kështu premtoi trajneri i Perusë, Rikardo Gareka, në konferencën e djeshme për shtyp. E thënë e bërë! Peruja, ndonëse e kualifikuar nga Botërori që pas ndeshjes së dytë në grup, gjen forca dhe mposht Australinë 2-0, një Australi që kishte pretendime të qarta, por që në fund iu përul vullnetit të amerikano-latineve.

MEKSIKË-SUEDI

Meksikës i duhet vetëm një pikë për të kaluar grupin, por Huan Karlos Ozorio deklaroi se në përballjen me Suedinë, skuadra e tij do të futet në fushën e lojës për të marrë fitoren. "E di që na mjafton një pikë, por kjo nuk ndryshon asgjë. Ne do të dalim në fushë dhe do të kërkojmë tri pikët. Nuk është në natyrën tonë të mos luftojmë për maksimumin. Një pikë na bën punë, por nuk kemi asnjë plan loje dhe asnjë strategji të tillë". Jane

Anderson vlerëson lojën e shpejtë të kundërshtarit



Anderson vlerëson maksimalisht Meksikën si një ekip me shumë talent, por ka ende një gozhdë për të shkukur nga ndeshja me Gjer-

maninë. "Meksika ka bërë një ndeshje spektakolare kundër Gjermanisë. Kemi respekt për ta pasi janë një nga ekipet më të talentuara të këtë botëror. Janë shumë të shpejtë në kundërsulm. Sa i takon Gjermanisë, më duhet të them se reagimi i stolit të tyre pas golit të Kros ishte i përshtirë. Vetëm një person me ndjenja të vdekur nuk do të kishte reaguar".

KORE-GJERMANI

Korea e Jugut ishte një ndër ekipet e para që u eliminua nga Kupa e Botës pasi humb dy sfidat e para në grup, ndërsa trajneri Shin Tae-Jong mendon të marrë një pikë përballë Gjermanisë. "Shansi për të marrë një fitore ndaj Gjermanisë është vetëm 1%, por unë mendoj se përderisa Meksika arriti ta bëjë, atëherë përderisa të mos e bëjmë edhe ne? Nuk ka ligj që thotë se nuk mund ta bëjmë, ndaj do ta provojmë".


Gjermania luan kualifikimin ndaj Koresë së eliminuar



Joakim Lëv është besimplotë para ndeshjes ndaj Koresë së Jugut. Fitorja me

përmbysje ndaj Suedisë, e bën optimist trajnerin gjerman para ndeshjes së fundit në grupe. "Jemi gati për Korenë dhe jemi gati për fitoren. Kam parë një skuadër shumë mirë psikologjikisht dhe besoj se edhe ndaj Koresë do vijojmë me fitoret. Në takimin e radhës, nuk do të kem Rudin, por Ozil është gati për lojë dhe e kam parë shumë mirë në stërvitjet e fundit".

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Një pije freskuese.
7. Graf ish teniste.
12. Dada, ish-diktator i Ugandës.
13. Eshhtë pasuri e investuar.
15. Mund të jenë fetare.
16. Një pjesë e relacionit.
17. Fillojnë ambalazhimin.
19. Një vegël.
20. Qe harkëtar i famshëm i akejve.
24. Fillojnë hetimin.
25. Një atentator vëtvrasës.
26. Kështu janë takimet zyrtare.
29. Eshhtë anije me dy skafe.
31. Fundi i Turandot.
32. Inicialet e Reitman regjisor.
33. Farrell regjisor.
34. Schneider që qe aktoe.

36. Mund të jetë e lirë për hartim.
38. Emri i Pasternak.
39. Ekberg e La dolce vita.
42. Dikur quhej Mediolanum.
43. Ruajnë pa ujë.
44. Një mund të jetë kalendrik.
46. Një është meskini, shpirtngushti.
47. Një hidrokarbur.
48. Mund të jetë franceskan.

**VERTIKAL**

1. Jessica Parker aktore.
2. Zola shkrimtar.
3. Janë dritë të tilla me parsec.
4. Mund të jenë gjaku.
5. United Kingdom.
6. Eshhtë njëri me principje.
7. Një polimer për kirurgji estetike.
8. Kufizojnë takimet.
9. Diftong teatral.
10. Fillojnë fluturimin.
11. Makina Uno.
14. Eshhtë shpend lagune.
18. Eshhtë operator që bën zoom.
20. Eshhtë i pashpirt.
21. Parashetë për një.
22. Pak enigmatike.
23. Një pjesë e Toskërisë.
25. Agustini ish-bomber.
26. Kufizojnë një princip.
27. Miku i Batman.
28. Tapeti për judo.
29. Janë stadt në videogame.
30. Béhet një kundër vendimit.
34. Janë me blerim mbuluar në një film
35. Eshhtë shtet aziatik.
37. Papavrami violinist
38. Fadili komik
40. Përhëndetja e Jul Qezarit.
41. Mbyllin fushatat.
42. Me të bëjnë një ketër.
45. Mbyllin një takimin.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**

1. Një pemë gjigante.
6. Janë për të kërcyer.
13. Ishte shkolla e Aristotelit
15. Një thirrje me emra.
17. Gjysmë rivalë.
18. Një pjesë e narkotikëve.
19. Një tis... mjegulle
20. E famshme ajo e Keopsit
23. Mbyllin një sirtar
24. Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
25. Fillojnë lejen.
26. Janë aktorë kryesorë.
29. Janë kompozime të kënduara.
30. Hudson aktore.
31. Satelit i Uranit.
32. Fillojnë tatëpjepën.
33. Mbetur në fund.
34. Sapo fillojnë.
35. Kastile janë në fund.


**VERTIKAL**

36. Kufij takimi.
38. Ekstremet e tokës.
40. Inicialet e Einstein.
41. Qendër mësimi.
42. Kështu thirrjej Marco Pantani.
45. Pak irredentizëm
47. Fundi i një filmi.
48. Popullojnë qytetin.
49. Janë gojë vullkane
50. Eshhtë edhe ai Persik.




9. Mbyllin portat.
10. Hagen rockstar.
11. Një pjesë e akademisë.
12. Bien me ballë.
14. Një barkë lëkurëkuqsh.
16. Aje ku shkon progresisti
20. Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
21. Një pjesë e minoritetit.
22. Eshhtë fluturues në ufo.
24. Do të bëhen mace të tilla.
25. Fletë pa kufij.
27. I ka tek rendi.
28. Kreshniku i volejbolit.
29. Një det që është liqen në fakt.
36. As unë, as ai.
37. Në mes të King edhe Cole të muzikës.
39. Një parashetë zmadhuese.
40. Eshhtë ilon papagalli.
41. Titulli i Sean Connery.
42. Fillojnë panikun.
43. Gjysma e rojave.
44. Fitim pa kufij.
46. Mbyllin një sherr.
47. Fillojnë një metodë.
48. Kufizojnë botimet.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			7	9		5			
9				4	6				
1		5		3				2	
							8	6	
6	1	3		2			4		
7						5			
			6		7	3			
		4			8		5		
	7							2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	2	6	8	3	7	4	5	9	
3	4	7	2	5	9	1	6	8	
8	5	9	4	1	6	2	7	3	
5	6	1	9	4	2	3	8	7	
7	3	2	1	6	8	5	9	4	
4	9	8	3	7	5	6	1	2	
9	8	4	5	2	1	7	3	6	
6	1	3	7	9	4	8	2	5	
2	7	5	6	8	3	9	4	1	



*Argëtim filozofik*

- E vetmja gjë e sigurtë për fatin, është se ndryshon.  
 - Nëse sillesh mirë me një kafshë, do të të dojë përgjithmonë. Nëse sillesh mirë me një njeri...paç fat.  
 - Ndonjëherë sakrifikon gjithçka për dikë. Dhe ai të sakrifikon ty për asgjë.  
 - Nëse duhej të mbyllim të gjithë idiotët në një dhomë të madhe, nuk do të kishte njeri që të mbyllte derën.



**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm



- Nëse i mohan të vërtetën një femre, dije se ajo do të bëjë të besosh vërtetë gjenjshtrata e sajë
- Në varrimin e së vërtetës, gjenjshtra mbajti një fjalim prekës
- Nuk ka rëndësi se kush, mjafton që dikush të dëgjon me të vërtetë...!
- Mos lejo kurrë që zemra të vendosi 'dhet' aty ku mendja është e sigurt që duhet vendosur 'pike'

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

MAKUTERI TITIM  
 AGARRRENDMIKRE  
 LITARETESO  
 ENILEAPELIMT  
 TELEDEPOZITAT  
 ATEKAPANONET  
 LKANARINENAME  
 ESENDAAMEANAR  
 CIPAMITETEEMER  
 MIKATEETEER  
 KORRIKURKOLELA  
 UNAZARENDORE

**FJALËKRYQI (2)**

MIRANDA BISHITI  
 IRAARMAADHID  
 TOAPARATEETA  
 INRI MOTETUMAR  
 IRDAMARETIL  
 IAKOTANTODAR  
 MKARINETEERAR  
 PURTENEENTIKRE  
 PERSEETINTIM  
 LAOIGOLALAKA  
 IHRTPETEERIKI  
 VOLEELENDEE

*Ehënie të mençura*

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

## Tashmë edhe lundroni!

